

## LAZËR STANI: Tradita e fuqishme nganjëherë kthehet në tabu penguese për shkrimtarin



Portreti nga Ina Lajthia

### OPINION

## DIKTATURA DIGJITALE

Nga Ardian Ndreca

(fq. 5)

### EKSPOZITA NË GKA




## SOKOL BEQIRI ART PËR TË MOS HARRUAR TMERRET E LUFTËS

Nga Suadela Balliu

(Fq. 12)

Fjala e mbajtur në Athinë me rastin e promovimit të librit "Harta e grisur", korrik 2012



## ALI PODRIMJA NUK JAM I VETVETES

(fq. 6)

"Gënjeshtarë të vegjël", Kongoli me romanin e ri,  
në një aventurë kryeqytetase

(Fq. 10)

Faslli Haliti, Realiteti dhe "nxirja e realitetit"

Nga Leka Ndoja

(Fq. 13)

Festivali i letërsisë "Polip", 40 shkrimtarë  
mblidhen në Prishtinë

(Fq. 7)

## "A MURGESHË, A LAVIRE"

Aktakuza publike  
e Andrej Zhdanovit  
për Anna Ahmatovën

Përkthyer dhe përgatitur nga  
Aurel Plasari



(Fq. 14)

"HEBRENJTË NË SHQIPËRI",  
NJË LIBËR I MONIKA STAFËS  
QË ZGJON INTERES  
TË VEÇANTË

(fq. 11)

### BIBLIOTEKË

#### FRIKA

tregim nga RAMIZ GJINI

PEIZAZH  
ME HËNË  
RUDINA ÇUPI



NJË RRAPËLLIMË ENERGJISH  
poezi nga  
DANIELE PANTANO



# LAZËR STANI:

## Tradita e fuqishme nganjëherë kthehet në tabu penguese për shkrimtarin

Intervistoi: Violeta Murati


**Njeriu i dosjes, Dënese në dru, Koba për nuse... janë titujt e parë që më vijnë në mend sapo përmendet emri juaj si tregimtar. Kur kjo ngulitje bëhet e natyrshme, çfarë do të thotë për një shkrimtar, pavarësisht se të tjerë tituj janë lënë jashtë, ndoshta edhe të rëndësishëm për ju si autor?**

Gjithmonë është kënaqësi për shkrimtarin kur dikush mban mend diçka të lexuar prej tij. Qoftë ky edhe një lexues anonim, i panjohur për ty, që jeton diku larg, që as e ke takuar dhe as do ta takosh kurrë. Nëse një libër, disa tituj librash, apo edhe një tregim i vetëm mbetet në memorien e lexuesit, shkrimtari ndihet i përkëdhelur. Se në kohët intensive që jetojmë, pothuajse 98 për qind e librave që botohen, harrohen brenda dhjetë viteve të para. “Njeriu i Dosjes” që ju e përmendni, është botuar 30 vjet më parë, në korrik të vitit 1989. Pra, ka mbijetuar për tridhjetë vjet në kujtesën e lexuesve, në kujtesën e studiuesve, të kritikëve, të gazetarëve të kulturës. Libri im i parë, i botuar në vitin 1993 nga Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve që drejtohej nga shkrimtari Zija Çela, nuk gjendet më askund, edhe pse u botua me një tirazh prej katër mijë kopjesh. Një ditë një lexues nga Mirdita më çoi të fotografuar kopertinën e këtij libri që e ruante në bibliotekën e tij personale. U ndjeva vërtet mirë. As librat e tjerë nuk gjenden në treg, përveç dy botimeve të fundit, “Kohë për Nuse” i ribotuar nga Enti Botues Fishta dhe “Rrugë pa krye” që është botimi im i fundit me esë letrare. Edhe pse leximi dhe tregu i librit janë futur në një krizë dramatike, prapë ribotimi i librit tri vite pas botimit të parë përbënte një ngjarje letrare për mua. Një libër që fiton çmimin e lexuesit, ka fituar çmimin më të madh. Aq më tepër që letërsia që shkruaj unë nuk ka asgjë të përbashkët me atë lloj letërsie që njihet si bestseller.

**Personaliteti juaj, në fakt, është disi i tërhequr, ndonëse me angazhime në dalje publike e debate politike. Nuk e kërkon protagonistizmin, aq më pak në letërsi... Është çështje besimi apo ka diçka tjetër që nuk shkon me lirinë?**

Të shkruarit, krijimi, është një akt shumë personal, proces i një vetmie të thellë, kur ti je vetëm, i rrethuar nga katër muret e heshtura të studios tënde. Është një akt i shenjtë që nuk bën as të përflitet dhe as të përgojohet. Edhe kur rri me miqtë e mi shkrimtarë, poetin Bardhyl Londo, shkrimtarin Zija Çela, poetin Visar Zhiti, apo

poetin Agron Tufa, rrallë flas për letërsinë. Letërsinë më shumë e kam dialog të brendshëm me veten në orët e vetmisë, në orët e pagjuma. Aty zënë fill edhe krijimet e mia. Qëndrimi i tërhequr, ngujimi në kullën tënde, nuk është akt mosbesimi. Unë nuk di të ketë besimtarë më të mëdhenj se sa murgjit që mbyllen në manastire. Nga ana tjetër, shkrimtari komunikon me botën nëpërmjet librave të tij. Nëse librat nuk arrijnë të komunikojnë, atëherë përpjekja për të komunikuar nga tribunat, nga ekranet e televizioneve, nga portalet apo gazetatat është një përpjekje e dështuar. Unë nuk bëj pjesë ndër ata shkrimtarë që rrinë duke bërë titur “Unë jam Shkrimtar!”. Një protagonizëm i tillë më duket i pakuptimtë, madje i dyshimtë. Ndoshta vjen nga dyshimi që bren nënvetëdijen tënde krijuese se librat e tu janë të përkohshëm, të harrueshëm, të papërfillshëm nga lexuesi. Madje, nuk kam organizuar kurrë një promovim libri. Nuk mund të organizoj një spektakël ku disa prej miqve flasin mirë për librin tim, si për një nuse të sapozbuluar nga duvaku, dhe që u kërkojnë të pranishmëve, miq dhe dashamirë të tutë, ose adhurues të letërsisë, që të blejnë e të lexojnë



librin tënd. Mbase jam i gabuar, por një imponim i tillë më duket i pamoralshëm. Natyrisht, kam marrë pjesë kur kam qenë i ftuar në takime të ndryshme me nxënës shkollash, studentë, apo konferenca e takime të organizuara nga bashkitë, shoqatat, bibliotekat.

**Për ta vazhduar pyetjen e mësipërme: shpesh, kur shohim shkrimtarë apo intelektualë të çdo fushe të përfshirë në politikë, na duket sikur diçka humbet nga personaliteti i tyre. Mendoni se ky është një rast precedent nga e shkuara jonë komuniste apo sot ky nivel nuk kryen akte, apo merr përsipër kauza të polisit - qytetit, qytetarëve? E shoh këtë mangësi, së paku në reflektimin mbi kulturën, politikat kulturore në vend. Si e shpjegoni?**


Kur shkrimtarët ftohen në politikë, natyrisht që ftohen për nevojat e politikës, jo për interesat e shkrimtarit. Në kohë të caktuara, politikës i është dashur imazhi publik i shkrimtarit, simpatia dhe adhurimi që lexuesit kishin për emrin e tij. Kjo është praktikuar sidomos në komunizëm, por edhe nga partitë që u krijuan pas viteve nëntëdhjetë. Megjithatë, pas viteve dymijë shkrimtarët u lanë jashtë politikës. Nuk u duheshin më njerëz që merrnin vota me imazhin dhe qëndrimin e tyre publik, por biznesmenë dhe njerëz me para që blinin vota. Është koha kur procesi elektoral degradoi në shitblerje të votës. Shkrimtarët u lanë jashtë vëmendjes së politikës, madje edhe të opinionit mediatik të kontrolluar nga politika.

Por shkrimtarët shqiptarë kanë një traditë të hershme të marrjes me politikë dhe kanë një kontribut të veçantë në krijimin e kombit dhe të shtetit shqiptar. Dëshmitë e shqipes së shkruar janë vepër e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë, Rilindja Kombëtare gjithashtu është punë madhore e shkrimtarëve, aq sa unë e kam thënë edhe herë tjetër se Kombi Shqiptar është një komb i krijuar nga shkrimtarët idealistë, pas asaj trysnie të madhe që krijoi pushtimi shumëshekullor Osman. Në vitet tridhjetë kemi emra të njohur të letërsisë që janë aktivë në politikë, si deputetët Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, apo Faik Konica, Fan Noli e shumë të tjerë. Mendoj se nga pjesëmarrja e tyre në politikë ka përfituar Shqipëria, jo ata vetë.

Shkrimtari, si qenie njerëzore, ka ndjeshmëri të lartë ndaj lirisë, padrejtësisë dhe vlerave humane. Pjesëmarrja e shkrimtarëve në politikë i rrit këto sensibilitete, e bën politikën më humane, nëse ai vërtet, duke qenë i pranishëm në politikë, e shpall identitetin e tij dhe nuk bën kompromis me vlerat në të cilat beson. Pra, nuk ka asgjë të keqe që shkrimtari të jetë pjesë e proceseve politike. Përkundrazi, është një investim për shoqërinë së cilës i përket, jo për atë vetë. Të mos harrojmë se një nga politikanët më të shquar shqiptarë të shekullit të njëzetë, Ibrahim Rugova, vjen nga bota e letrave. Natyrisht, imazhin e keq të shkrimtarit në politikë e krijoi diktatura, nga përdorimi i përdhunshëm që u bëri disa shkrimtarëve.

**Keni thënë se çlirimi nga tabutë është një hap drejt lirisë në përgjithësi dhe lirisë krijuese në veçanti. Por edhe ky proces është kaq i ndërlikuar... Çfarë keni pasur parasysh me këtë?**

Julio Cortazar në librin e tij të njohur “Rreth ditës në tetëdhjetë botë” shkruan: “Të gjithë shkrimtarët europianë janë skllëvër të baptizmit të tyre; nëse mund të parafrzoj Rimbaud-in, na pëlqen ose jo, të shkruarit e tyre mbart bagazhin e një tradite të madhe, pothuajse të frikshme; e pranojnë këtë traditë apo luftojnë kundër saj, ajo jeton brenda tyre, është familjarja dhe sukuba e tyre.” Pra, tradita e fuqishme nganjëherë kthehet në tabu penguese për shkrimtarin. Tabutë e tjera janë më pak penguese, më pak të përfillshme nëse kemi të bëjmë me një mendje krijuese. Dhe një mendje krijuese nuk mund të jetë ndryshe, veçse një mendje e lirë. Kur fillojnë kufizimet, autocensura, frikërat nga tabutë, procesi krijues meket, liria krijuese shuhet. Ne, ndërkaq, nuk kemi një traditë aq të fuqishme sa ta skllavërojnë shkrimtarin e sotëm



shqiptar, pavarësisht arritjeve të letërsisë shqipe në historinë e saj. Përkundrazi, ajo është inspiruese. Natyrisht, edhe shkrimtari është njeri dhe si njeri ka kufizimet e tij, kufizime që shkrimtari nuk mund t'i dallojë te vetvetja. Ne nuk mund të jemi më shumë se vetja jonë në letërsi, se vetja jonë më e mirë që jeton ndoshta edhe si e panjohur brenda nesh.

**Të shkruash kur ke diçka për të thënë – duket se kjo është linja e tregimeve që keni botuar. Me sa ju kemi ndjekur, librat tuaj janë moment, si një kohë e caktuar. Është ideja e intensitetit të krijimit, kur...?**

Nuk e kuptoj se si mund të shkruash kur nuk ke asgjë për të thënë. As të flasësh nuk flet dot nëse nuk ke diçka për të thënë. Ndryshe, të shkruarit kthehet në sindromë, të folurit në ves. Të shkruarit te shkrimtari vjen natyrshëm, në mënyrë befasuese. Ti je rrugës duke ecur dhe papritmas e gjen veten brenda një historie, ose ndodhesh i shtrirë në shtrat, duke u përpëlitur në orët e pagjuma, dhe papritmas rrëmbehesh nga një frazë, nga një histori, nga një rrëfim, nga një subjekt... Unë nuk mbaj kurrë shënime. Nuk e di nëse është e mirë apo e keqe mosmbajtja e shënimeve, por me vete kam menduar se ato histori që harrohen nuk meritojnë të shkruhen. Diçka që nuk mbijeton brenda meje, vështirë se do të mbijetonte te lexuesi. Ndodh që disa tregime apo subjekte i kam mbajtur disa vjet në mendje, pastaj në një moment të dhënë jam ulur dhe i kam shkruar me një frymë. Si tregimin “Daiza Zaharia”, për shembull, botuar në librin “Kohë për nuse”. Ka një distancë të madhe midis asaj që krijohet brenda teje dhe tekstit të shkruar. Shkapërcimi i kësaj distance jo gjithnjë është i mundur. E pashkruara gjithmonë është më shumë se ajo që ke shkruar dhe publikuar dhe kjo e bën procesin e krijimit të pandalshëm.

**Ndoshta jeni nga të rrallët shkrimtarë që ndiqni “gjithë jetën” një zhanër: tregimin. Ju vini nga një formim joletrar, por besojmë se ka një shkak, nxitje**

**të hershme, pse sot ju quajmë shkrimtar. A keni një histori, zanafillë, që iu përcaktoi të tillë?**

Shkrimtari nuk bëhet nga shkolla, shkrimtari lind. Mund të bësh të gjitha shkollat, të jesh njeri shumë i ditur, por nuk je shkrimtar. Shkolla, në rastin më të mirë, të shkurton rrugën midis shkrimtarit të lindur dhe shkrimtarit të realizuar. Është si një lloj harte orientuese që të shpëton nga sorollatjet e pafundme në pyll. Unë, në fakt, doja të studioja për letërsi, por asnjëherë nuk m'u dha kjo mundësi. Tani e konsideroj fat që studiova në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në degën e biologji-kimisë. Ishte, ndoshta, ndër të paktat fakultete ku merreshin dije të pamanipuluara dhe ushtrije të menduarit konceptual. Aq më tepër që unë i doja shkencat, fizikën, kiminë, biologjinë. Ndërsa Fakulteti i Letërsisë, për fat të keq, ishte një fakultet doktrinar, joshkencor. Dijet e mia për letërsinë i kam krijuar nëpërmjet leximeve të shumta, në mënyrë autodidakte, krejt i pandikuar nga shkolla zyrtare, metoda sunduese, propaganda letrareske, kritika e indoktrinuara. Në lirinë që të krijon leximi, refuzon gjithçka që nuk pranohet natyrshëm prej teje dhe pranon atë që krijon harmoni me ty, me shpirtin tënd. Dhe që herët kam shkruar, por vetëm për vete, pa i ndarë me askënd shkrimet e mia. Kur më mërzhiteshin, i grisja të gjitha dhe pas një kohe bukur të gjatë, ndoshta pas disa vjetësh, gjithçka rifillonte nga e para. Më kujtohet se, si student, dërgova një tregim në gazetën “Studenti”. Ngjarjet e tregimit i kisha vendosur në një nga republikat baltike, në Letoni më duket. E lexuan tregimin dhe vendosën të mos e botonin, ngaqë menduan se duhej të ishte i përkthyer nga ndonjë autor i huaj. Unë u gëzova shumë kur mësova se çfarë kishte ndodhur. Ata nuk e besonin se një student i Shkencave të Natyrës, krejt i panjohur në letërsi, mund të shkruante një tregim të tillë. Pra, sipas mendjes së tyre, unë me siguri e kisha përkthyer, ngaqë e dinin se zotëroja mirë disa gjuhë të huaja. Por akuza e tyre e marrë më dha shumë siguri te vetja, pavarësisht se

tregimi nuk u botua kurrë dhe një ditë nuk e di se ku e humba. Edhe pse disa vjet nuk u mora më me shkrim letrar. Tregimin e parë të publikuar e shkrova pas disa vjetësh, mbi një tabak letre, ndërsa bëja dëzhurnin e detyruar në shtypshkronjën ku shtypej gazeta në të cilën punoja. Tregimi quhej “Emri im i bukur”. Pak narcisit apo jo? Pas disa ditësh shkrova tregimin “Mara nuk është e qartë”, tregim që u botua në gazetën “Zëri i rinisë” dhe pati një pritje shumë të mirë midis kolegëve. Një kolege e quajti tregimin më të mirë të botuar në letërsinë shqipe në dyzet vjet. Natyrisht, e tepronte. Kur botova librin e parë, nuk e përfshiva këtë tregim të hershëm. Më dukej se ai tregim kishte njëfarë ndikimi të padukshëm nga Çehovi, kështu që e lashë jashtë librit. Doja dhe dua që në letërsinë time të jem vetëm unë, askush tjetër. Ndërkaq, vërtet, kam botuar vetëm libra me tregime, por kjo nuk do të thotë se nuk shkruaj edhe gjëra të tjera.

**Vazhdon të jetë një kujtesë e çuditshme për shkrimtarët shqiptarë gazeta “Drita”, që pushoi së ekzistuari pas '90-ës me rënien e diktaturës. Ka nostalgji për të. Ju si e kujtoni botimin aty?**

Gazeta “Drita”, me gjithë censurën e kuptueshme për atë kohë, ishte gazeta më e rëndësishme për inteligjencën krijuese dhe shumë e dashur për lexuesit. Tregimin e parë në atë gazetë e kam botuar në vitin 1988. Tregimi titullohej “Fundi i shëtitjeve natën”. Vite më vonë, Luljeta Lleshanaku më ka treguar se kur e kishte lexuar atë tregim, i ishin mbushur sytë me lot. Nuk i kishte ndodhur të lexonte kurrë në shtypin shqiptar një tregim aq të dhimbshëm për dramën e individit, dramën e njeriut në shoqëri. Dhe mua, siç më ka treguar pasi u njohëm, më kishte përfytyruar si një burrë diku rreth të pesëdhjetave dhe shumë kurajoz, që guxonte të shkruante gjëra të tilla. Kur u prezantuam rastësisht një vit më vonë, mbeti e habitur që ai flokëthinjuri pesëdhjetëvjeçar ishte një djalë diku rreth të tridhjetave.

Me Bardhyl London, mikun tim, prisnim sezonin e pushimeve që të botonim krijimet tona në gazetë. Pra, kohën kur të mëdhenjtë thyenin qafën plazheve dhe ne ndiheshim pak më të lirë. Kështu vepruam me Bardhin në gusht të vitit 1989. Ai botoi poemën e tij të njohur “Ditë njerëzore”, ndërsa unë tregimin “Orët e pagjuma”. Arshi Pipa, si një vëzhgues i vëmendshëm i procesit letrar shqiptar, e komentoi poemën e Bardhit te *Zëri i Amerikës*, duke ia komplikuar disi situatën. Ai, nëpërmjet botimeve në fundin e viteve tetëdhjetë, parathoshte atë që do të ndodhte vetëm një vit e gjysmë më vonë: hapjen e Shqipërisë ndaj proceseve demokratike.

Ama me Bardhin kam një histori të bukur. Në vitin 1990 i dërgoj një tregim me titullin “Margaritarët”, të cilin e kam botuar në librin e parë. Pasi e lexoi, më tha se tregimi do të botohej të dielën e ardhshme. Pas disa ditësh më merr në telefon e më thotë të shkoja ta takoja.

“Nuk mund ta botoj tregimin, se është pornografik dhe na merr në qafë të dyve. Guaska që përshkruan në tregim, është metaforë e seksit të femrës”.

“Kush dreq femre e paska lexuar, se ty me siguri nuk do të shkonte mendja për këtë”, - i thashë.

Pimë kafe bashkë dhe i premtova se herën tjetër do t'i dërgoja një tregim të tredhur, pa seks. Bardhi u shkri së qeshuri. Pastaj më takoi të punoja tre vjet në gazetën “Drita”, 1991-1993. Mendoj se kanë qenë vitet më të mira të kësaj gazete në historinë e saj. Tirazhi shkonte mbi njëzet mijë kopje. Ne nuk kishim letër, por kërkesa e tregut ishte edhe për më shumë. Natyrisht, kohët kanë ndryshuar dhe sot nuk e kemi më një gazetë të tillë.

**Nga lindin historitë, çfarë trazon në ju lënda letrare në raport me realitetin, idetë (mund të sjellësh edhe shembuj konkretë)?**

Përgjigjen më të mirë më duket se e ka dhënë Brodsky kur e pyetën në gjyq se nga i vinte poezia. “Mendoj se kjo vjen prej Zotit”, - tha. Pikërisht për



këtë, letërsia, krijimi, arti në përgjithësi, ka diçka hyjnore dhe si rrjedhim, diçka të pashpjegueshme në vetvete. Nuk bëhesh shkrimtar se ke dëshirë të bëhesh, se e mëson zanatin në shkollë, se i vë detyrë vetes të shkruash. Gjithçka është e lindur brenda teje, vjen natyrshëm, si një befasi, si një zbulesë. Ndodh që të shfaqet në ëndërr si një fat i parathënë, kur je duke udhëtuar me tren së bashku me qindra pasagjerë të panjohur, kur je duke shëtitur vetëm në pyll apo duke bredhur pa asnjë qëllim në kokë anës lumit. Mua më së shumti më ndodh në orët e pagjuma, në qetësinë e thellë të natës, kur përpëlitem në shtrat me gjumë të arratisur. “Korbat”, për shembull, jam ngritur nga shtrati në mes të natës dhe e kam shkruar për një çerek ore. Kur kam shkruar “Margaritarët”, mbaj mend se isha i sëmurë keq me grip. Dola në korridor, nxora një tryezë aty dhe i mbështjellë me batanije, e shkrova brenda një pasditeje. Ose një nga tregimet e fundit që kam shkruar, “Diçka i mungon asaj gruaje”. Rilexova tregimin tim “Rruga e Pyllit”. Ndieja se diçka i mungon atij tregimi. Mora e dhashë me veten se çfarë pikërisht i mungonte, por për shumë e shumë ditë nuk e gjeta. Atëherë, pikërisht për këtë, shkrova një tregim tjetër të shkurtër, që tani gjithsesi e dua. Pra, nuk ka as shpjegim bindës se nga vjen dhe pse shkruhet një tregim. Thjesht ndodh.

**Tregimin “Njeriu i Dosjes”, një nga krijimet tuaja më të hershme, thoni se e keni shkruar me një frymë një mbremje marsi të vitit 1989. Mund të themi se ishte një tregim “i parakohshëm” për dosjet, që tronditi jo pak njerëz. Kujtojmë se Arshi Pipa i ka bërë edhe një analizë letrare-politike... S’ka qenë e lehtë në ato fillime të hyje si shkrimtar “politik”, ndonëse jeta juaj letrare shpesh është dyzuar në këto vite. Çfarë kujtoni nga kjo histori sot?**

Nuk jam shkrimtar politik, asnjëherë nuk e kam pasur një qëllim të tillë. Por koha në të cilën u botua tregimi i dha atij një kontekst të fortë politik. Për këtë kam shkruar edhe një esë të gjatë të botuar në librin “Rrugë pa krye”. Arshi Pipa i bëri një lexim të fortë politik, por unë, mbi të gjitha, them se është një krijim letrar. Është kjo arsyeja që më nxiti të shkruaj edhe një esë të gjatë për këtë temë.

**Tregimet tuaja priren nga njeriu ekzistencial, dilemat, çfarë është natyrë burimore, origjinë e jetës vendase, lokale... Shumë besojnë se universalizmi në letërsi s’ka punë me lokalen. Ju si e mendoni, ç’kontekste përfshin sot letërsia?**


Nuk ka letërsi lokale, krahinore, fshatare, qytetare, femërore, mashkullore. Edhe klasifikimet që bëhen nga shkollat letrare janë tepër të dyshimta, kanë thjesht karakter didaktik, ndaj kurrë nuk i kam marrë seriozisht. Megjithatë, këtu krijohet gjithmonë një keqkuptim i madh, sidomos te shkrimtarët e rinj, që duan me patjetër të bëhen të mëdhenj, të rrokin tema universale. Ernesto Sabato, në një bisedë, duke iu drejtuar shkrimtarëve të rinj, pyeste: A do të bëhesh shkrimtar apo i famshëm? Dhe shtonte: Se fama dhe shkrimtari nuk janë e njëjta gjë.

Mua më kujtohet një lexues imi, shumë dashamirës, por pak naiv. “Shiko, - më thoshte, - shkrimtarët e mëdhenj merren me personazhe të rëndësishme të historisë: Homeri merret me heronjtë e lashtësisë, Shekspiri me mbretër, Ismail Kadare me ministra, sulltanë, kryetarë shtetesh”. Mua më vinte për të qeshur me këtë këshillë, por për mirësjellje kafshoja buzën, qëndroja serioz dhe e dëgjoja gjithë vëmendje. Të ndjekim logjikën e kundërt: një nga tregimet më të bukura dhe më universale që kam lexuar në jetën time është “Gimpel Idiotti” i Isaac Bashevis Singer, edhe pse personazhi është një djalë gjysmë i metë, i vonuar. Arëmatësi i “Kështjellës” së Kafkës është një nëpunës i rëndomtë i shtetit, por mbetet gjithashtu një ndër veprat më universale të shkruara ndonjëherë. Sepse vetë njeriu si qenie, pavarësisht nga lokaliteti ku banon, pozicioni në shoqëri, shteti ku jeton,

nacionaliteti të cilit i përket, gjuha të cilën flet, është një qenie universale. Brenda një individi të vetëm është i kondensuar i gjithë universi. Të paktën unë kështu mendoj.

**Sapo keni ribotuar librin me tregime “Kohë për nuse”, ku fëmijëria krijon tharme rrëfimesh. Çfarë më bën përshtypje, është se librat më të mirë të shkruar nga autorët tanë burojnë pikërisht nga histori të fëmijërisë. Ç’është kjo “moshë” për ju, apo ka idealizim?**

“Gjithçka është kremtim në kopshtin e egër të fëmijërisë”, - shkruan në njëren nga poezitë e tij Pablo Neruda. I tillë është edhe kopshti i egër i fëmijërisë sime, një kremtim që nuk mbaron. Pikërisht për këtë, fëmijëria është shumë e pranishme te secili autor. Duket se dalja nga fëmijëria është si një arratisje nga parajsa në të cilën nuk mund të kthehesh më kurrë: Në njëfarë mënyre, fëmijëria ime ka qenë shumë e begatë, e populluar me njerëz shumë të veçantë, me ngjarje, histori, ndodhi, rrëfime pafund. Pastaj, si fëmijë me imagjinatë, zotëroja aftësinë për t’ia begatuar fëmijërinë vetes, pavarësisht kushteve të vështira në të cilat u rritëm. Këtë aftësi e ruaj edhe sot e kësaj dite, aq sa vetë fëmijëria ime më ngjan si *fiction*.



**Natyrshëm flasim për Dukagjinin tuaj... Arketipi juaj në letërsi a merr, a buron, prej andej?**

Unë kam lindur në Dukagjin, aty jam bërë katërmëdhjetë vjeç. Kam jetuar aty edhe tre vite të tjera, pas mbarimit të shkollës së mesme, ndërkohë që prisja të vazhdoja studimet e larta. Them se Dukagjini ka qenë biblioteka ime e parë e madhe, më e pasura që mund të ekzistonte. Sot ai Dukagjin i projektuar brenda meje nuk ekziston më, siç nuk ekziston më ai Dukagjin që na e sjell në librin e saj “Majat e Shalës” Rose W. Lane. Kur lexova për herë të parë librin e Lane-s, më dukej se unë po e zbuloja Dukagjinin që nuk e kisha njohur, edhe pse isha lindur e rritur aty. Pas gjashtëdhjetë vjetësh, unë njihja një Dukagjin tjetër, që gjithashtu ishte magjepsës. Dhe tjetër është Dukagjini që njohin vajzat e mia, por që mbetet gjithashtu magjepsës dhe shumë i dashur për to. Dukagjini ndryshon nga dhjetëvjeçari në dhjetëvjeçar, por duket se magjepsjen e ruan të përjetshme.

**Si e krijon njeriu lirinë? Çfarë ju ka bërë të lirë, sepse shpesh vërehet te ju ideja e “arratisjes”, ikjes... apo?**

Në anët e mia, pleqtë e shtrirë në shtratin e vdekjes, para se të jepnin frymën, u thoshin të gjallëve që po linin pas: “Po ju la të lirë e të bekuem.” Kjo ishte trashëgimia më e madhe që plaku i shtëpisë mund t’u linte të gjallëve: Lirinë dhe Bekimin e Zotit. Them se kjo shprehje duhet të jetë shumë e vjetër, vjen nga kohët e lashta të pushtimeve të gjata. Por Dukagjini në vetvete nuk ishte pushtuar kurrë nga asnjë pushtues, ishte bërë si një strehë për njerëzit e lirë, ku, siç thuhet, erdhën edhe të parët që themeluan fshatin tim, aty nga fundi i shekullit të shtatëmbëdhjetë. Ndoshta kjo ndjenjë e fortë për lirinë u ngulit fort tek unë në mënyrë të pavetëdijshme, edhe pse linda në një kohë të keqe për lirinë. Dhe njeriu që është lindur me lirinë, që është rritur bashkë me të, nuk mund të heqë dorë kurrë prej saj.

**Tani që hapësira reale e shqipes, gjeografia, pothuaj është dyfishuar, do të thotë treg më i madh për librin, mundësi më e madhe njohjeje, por nuk po ndodh kështu. Në të dyja vendet, Shqipëri e Kosovë, a mjaftojnë vetëm agjendat politike, sipas atyre për kalendarë kulturorë? (Rasti juaj, kritika nga Kosova ka folur më shumë mbi librat tuaj sesa këtu në Shqipëri!)**

Integrimet kulturore të të gjithë hapësirës shqiptare janë të pashmangshme, jo për meritë të politikës, por si atribut i lirisë që kemi fituar në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, kudo ku jetojnë shqiptarë. Tregu gjeografikisht është zgjeruar, por hapësira e librit është ngushtuar për shkak të tëhuajësimit të njerëzve me librin. Si mund të shmanget ky impakt negativ? Kjo është një çështje që kërkon vërtet studim. Por mendoj se duhet një përmbyse në mentalitetin tonë mbizotërues në këto vite nga institucioni bazë i familjes, e deri tek institucionet më të larta të shtetit.

**Bashkë me poeten Luljeta Lleshanaku, bashkëshortja juaj, jeni dy individë që “luftoni” për të njëjtin territor. Si ka qenë jeta juaj, a ia dilet jetesa vetëm me librin?**

Është një sakrificë, sigurisht, por mendoj se secili krijues ka territorin e tij të pafundmë, ka universin e tij, ku nuk mund të depërtojë askush tjetër. Një herë Luljeta, pasi lexoi një nga tregimet e mia të shkurtra, më tha: “S’më le vend. Ke hyrë në territorin tim. Ky nuk është tregim, është poezi.” “Në letërsi nuk ka tokë të xanun”, - iu përgjigja unë dhe qeshëm të dy.

**Duke iu referuar se çfarë dëmi shkakton te brezi i ri mosleximi, keni thënë: “Po shkojmë drejt një shoqërie shpirtërisht të zbrazët dhe intelektualisht të kufizuar...” A nuk është tepër e zymtë kjo qasje?**

Më tregonte miku im Visar Zhiti se para disa vjetësh në Itali sondazhet treguan se leximi i librit kishte rënë me dy për qind dhe u bë alarm kombëtar. Kam pyetur librarët këto ditë dhe më kanë thënë se shitja e librit në pesë vitet e fundit ka rënë me dyzet për qind. Pas këtij konstatimi, pyetja që shtrohet është: ku po shkojmë? Natyrisht, drejt një shoqërie shpirtërisht të zbrazët dhe intelektualisht të kufizuar. Por te ne askush nuk i tund kambanat e alarmit.

**Cilët janë shkrimtarët shqiptarë që admironi dhe ndihen të rëndësishëm për ju? Kam parasysh letërsinë shqipe të ’900-ës...**

Kam dy autorë veçanërisht të dashur, Ernest Koliqin dhe Mitrush Kutelin. Ama e dua çdo libër të vjetër, Naimin që shkroi “Bagëti e bujqësi” me një shqipe të kulluar, Fishtën për leksikun e jashtëzakonshëm, Kristoforidhin në një botim të papërpunuar gjuhësisht të vitit 1930 për shqipen e mrekullueshme. Dhe shumë tekste të vjetra këngësh arvanitase, arbëreshe, tekste të këngëve të vjetra të Veriut, Eposin. “Fort po shndrin njaj diell e pak po nxen”. Që në vargun e parë poeti anonim i së shkuarës, të ul siparin e një tragjedie që pritet të ndodhë. Ka më bukur?



# DIKTATURA DIGJITALE

Nga Ardian Ndreca

Dy muajt para se me vdekë, në janar të vitit 2007, Jean Baudrillard, filozof francez që ka reflektue thellësisht rreth postmodernitetit, ishte gati në përfundim të një sprove që do të botohej ma vonë me titullin “Pse nuk është zhdukë tashma gjithçka?” (*Pourquoi tout n'a-t-il pas déjà disparu?*).

Bahet fjalë për përsiatjet e fundit që janë ndërkaq mendimet ma të ngulituna të këtij mendimtari bashkëkohor, të cilat kanë të bëjnë me gjendjen e njerzimit në epokën që jetojmë sot. Autori nisat prej premisë që gjanat në momentin e realizimit të tyre zhduken si të tilla e marrin trajta tjera; së dyti, pohon ai, teknologjia e sotme tregon kufijtë gjithnjë e ma të prekshëm të njeriut, i cili po ia dorzon vetveten një bote të panjohun, artificiale në të gjitha komponentet e saj, sidomos në inteligjencën e saj.

Ndryshe nga sa mendonin filozofët e arsyes së fortë, bota në të cilën ne jetojmë nuk ka nevojë për me ekzistue si e tillë falë të kundërtave. Prej Hegel-it, e ma vonë prej Marx-it e këtej, ishim mësue me e pa të interpretueme botën falë kundërshtive dhe dialektikës së të kundërtave. Sot të kundërtat e kanë humbë forcën e tyre, ideologjitë e forta kanë ra (mes së majtës dhe së djathtës nuk ekziston ma kundërvumja ideologjike e dikurshme, por vetëm gara për marrjen dhe mbajtjen e pushtetit). *Kundërshtarët tanë na kërcënojnë me zhdukjen e tyre*, pohon filozofi francez. Mund të themi se këtë gja Perëndimi e ka eksperimentue ma së mirit me hutimin e madh që pasoi ramjen e Murit e Berlinit.

Megjithatë, ideologjitë në pamje të jashtme të zhdukuna, rregullat e thyeme, kontrollet dhe censurat e hequna, janë ba pjesë e nënvetëdijes sonë, tue diktue stilin e sotëm të jetës dhe çdo modul që pretendon me u imponue si universal dhe mban vulën e *politically correct*.

Realiteti, shton Baudrillard, asht zhdukë mbas virtualitetit, dhe ky i fundit po dikton fuqishëm rregullat e jetës sonë. Mjafton të kujtojmë këtu fluskën e sapunit të ekonomisë virtuale, e cila në euforinë e saj financiare-spekulative shkaktoi një krizë reale. Ky asht paradoksi: diçka që nuk ka realitet ndikon mbi realitetin tue modifikue atë dhe vetë qenjen tonë.

Këtë “revolucion antropologjik” Baudrillard e ndjek prej afër në kalimin prej fotografisë analogjike tek ajo digjitale. Kjo e fundit shpalos një potencialitet

të papamë, pse nuk ka nevojë për negativin dhe madje nuk ka nevojë as për dritën e synit të atij që e përdor. Përlllogaritja elektronike, me sa duket, e ka fitue betejën e saj me formën artistike. Kur shkrepim një foto digjitale, ne nuk paraqesim (*représentation*) një objekt, por thjesht e kapim atë në kushtet ma të mira matematike që i përcakton teknologjia e naltë që përdorim.

Ajo që nuk gjejmë ma në foton digjitale, simbas Baudrillard, asht: “pasunia e lojës së pranisë dhe mospranisë”... “e gjithë pasunia e gjestit fotografik që zhduket me hymjen në lojë të digjitales”.

Kjo gja nuk përban thjesht një hap të teknologjisë, por një ndryshim rranjësor në mendësinë tonë: “Edhe një herë, ky nuk asht veçse një shembull i asaj që po ndodh në mënyrë masive në të gjitha fushat. Në veçanti në fushën e mendimit, të konceptimit, të gjuhës dhe të përçansimit logjik (*représentation*). *I njëjti fat digjital kërcënon universin mendor dhe gjithë shtrimjen e mendimit*.”

Iluzioni që po krijohet asht ngatërrimi i mendimit me shumësinë e përlllogaritjeve, ngatërrimi i fotografisë me shkrepjet e panumërta digjitale.

Rreziku qëndron te kthimi i trunit në një receptor imazhesh, rreth të cilave ai e ka humbë forcën kritike. Sot, ma shumë se dje, jemi të bombarduem prej një pafundësie pamjesh që vijnë drejt nesh nga çdo anë e globit dhe që flasin të njëjtën gjuhë: *digjitale*. E keqja asht se rreth tyre ne kufizohemi në gjykime mbas të cilave nuk qëndron asnjë përpjekje intelektuale me kuptue, por vetëm një aprovim apo një mosaprovim që vjen së bashku me figurën digjitale. Kjo përban hegjemoninë e arsyes artificiale mbi arsyen njerzore.

Digjitalja ka dhunue shembëlltyrën e gjanave, nënvizon Baudrillard, tue mos lanë vend për imagjinatën dhe për pasuninë e saj subjektive. Fotografia digjitale ka anullue negativin, kohën e pritjes që i jep fotos një vlerë shtesë, prekjen artistike, të përtëjmen. Fotografia analogjike asht një përshkrim i pasunuem prej ndërveprimit të dritës së synit të fotografit me atë që ndriçon objektin.

Ne, në gjuhën shqipe, kemi përbujtë dikur për pak kohë një neologjizëm, në mos gabohem të mësuesit të madh Matí Logoreci, që s’ka pasë shumë fat: *dritëshkronjë*. Fotografia analogjike asht shkrimi



me anën dritës, jo kapja elektronike, zbërthimi (pikselizimi) dhe konvertimi digjital i imazhit.


Kjo asht arsyeja që shtyn Baudrillard-in me qenë shumë skeptik ndaj mundësisë së trajtimit të fotografisë digjitale si art, mbasi asaj i mungon mbivlera e dritës së synit të artistit.

“Andro një shembëlltyrë, - shkruen ai, - që të jetë shkrimi automatik i së veçantës së botës”. Tue citue debatin antik rreth ikonoklastisë, ai pohon se andron një shembëlltyrë që të përmbajë pa ndërmjetsimin e përlllogaritjeve matematike esencën hyjnore të realitetit, një shembëlltyrë *akeropite* (pa ndërmjetsimin e artificiales), diçka që ngjason me të ashtuqejtunin “veli i Veronikës”, diçka që nuk mund të riprodhohet në seri pa e humbë përshtirshmërinë e vet.

Duhet që shembëlltyra ta rifitojë sovranitetin e saj tue u çlirue prej realitetit digjital që na përmbytë me zingjirin e pafund të sekuencave fotografike, ashtu si edhe mendja njerzore të rikthehet në vlerësuese të cilësive të universit. Vizioni global i botës asht një kërcënim që rrjedh prej software-ve gjithnjë e ma shumë universale që lejojnë kapjen e imazheve dhe konsumimin e tyre të menjihershëm; madje edhe ndërhyrja e vetme, ajo me *photoshop*, bahet në mënyrë digjitale.

\*\*\*

Në librin e tij “You Are Not a Gadget”, Jaron Lanier pohon se kemi hy tashma në epokën e totalitarizmit digjital, i cili asht një lloj “maoizmi informatik”, ku vendin e individit po e zen gjithnjë e ma shumë kolektivi dhe anonimati. Në pamundësi me krijue gjana origjinale që të mbesin, njeriu i mijëvjeçarit të tretë, thekson Lanier, po kërkon pavdekësinë digjitale, tue ngatrrue randshëm identitetin kibernetik me atë real. Për shembull, një prej *cultural turns* bashkëkohore asht edhe *remix*-i dhe *cover*-i, që konsistojnë në përdorimin e ideve të t’jerëve. Ideali i dijes nuk janë ma bibliotekat por njohuritë e prodhueme kolektivisht të wikipedistave. Lind dyshimi nëse kjo dije kolektive pa një autor të mirëfilltë do të mund të na lejojë vërtet me u ba të pavdekshëm apo asht thjesht një iluzion komercial kalimtar dhe pseudodemokratik! Simbas Lanier, bloggersat dhe komentuesit logoirrikë gjithnjë online, që shprazin frustrimet e tyre për dështimet e njimbasnjishme personale apo thjesht pakënaqësitë, inatet dhe paragjykimet e mbulueme prej anonimitetit të kolektivit nuk do të prodhojnë kurrë një Bob Woodward apo një Carl Bernstein, e shtojmë ne, as një Indro Montanelli, Igor Man, Oriana Fallaci, David Leigh. Asht e çuditshme se sa larg ka shkue fjala “virtual” në rastin e lokucionit “realitet virtual e digjital”; rranja e saj asht “vir” që domethanë *burrë i fortë*, kushedi sesa forca mshehet mbas një realiteti që nuk ekziston realisht?



Jean Baudrillard



Në korrik të vitit 2012, në një prej amfiteatrove të Athinës, poeti Ali Podrimja, me rastin e promovimit të librit poetik “Hartë e grisur”, në gjuhën greke, flet enkas për këtë takim, – “Nuk jam i vetvetes” – ku rrëfen për lirinë, të shkuarën dhe problemet e së ardhmes, krijimin, librat, kritikën, përballjen e shkrimtarëve, letërsinë e tyre, shtetin totalitar dhe autorin, si funksionojnë qarqet letrare të të dyja vendeve, Tiranë e Prishtinë...

## ALI PODRIMJA NUK JAM I VETVETES

Krijuesi ka punë me magjinë dhe me të menduarit. Përkushtimi i njëmendtë e ngre atë në individualitet. Megjithatë, ekzistojnë gjëra për të cilat nuk mund të thuash se je i pari, që merresh me këtë apo atë çështje. Përpykjet për origjinalitet janë sizifiane. Bota është harxhuar shumë dhe aq shumë është eksploatuar gjuha, sa njeriu dridhet kur tenton të lërë diçka në letër e bardhë.

Rreth motivit të labirintit ishte diskutuar gjatë kush e ka imituar tjetrin. Kafka apo Borhesi. Ndikimi për e rreth labirintit te këta dy kolosë ishte nga një i tretë, sofisti i lashtësisë greke, Zenon. Gilles Lapouge, në një tekst të tij rreth këtij problemi te shkrimtarët e nderuar, e shihte te degëzimi i ideve.

Borhesi mbështet idenë se shkrimtari krijon pasardhësin e vet. Kjo do të thotë se ne jetojmë dhe e lexojmë jetën në variante.

Për përkimet mes krijuesve kisha dëgjuar. Do përmend dy poetë gjenialë: Lasgush Poradecin dhe Emineskun: kanë ndonjë afri idesh, motivesh, simbolesh, formash; fjalë karakteristike nga leksiku, por nuk bën të pranohet rrënimi i gjenit shkaku i ambicieve të ca liliputëve, që artin e jetën e shihnin nga një dritare e zymtë.

Qarku letrar i Prishtinës, siç ka zënë të thuhet e që ishin ndeshur me realizmin socialist. Në vitin 1971 botuan një tekst problemor “Vox clamantis in deserto”. Qëndrimin e tyre e kishin dëshmuar edhe në krijimtari. Arsyet pse nuk e pranonin, ishin se nuk mund ta pranonin një artikulum të dështuar, as doktrinat ideologjike, ku imazhi shqiptar ishte mjaft pikëllues. Pra, mungonte letërsia e mirëfilltë.

Buzë plazhit të Ilirisë më projektoheshin vitet e 60-ta. Në poezinë shqipe hetoheshin përkimet me poezinë spanjolle, sidomos me Lorkën e Maçadën, po edhe me ca poetë europianë, posaçërisht prania e Aragonit. Megjithatë, përkimet luajtën rol në afrimin e kulturave dhe popujve. Ca motive nga lashtësia sot e gjithë ditën trajtohen në mënyrë të vet si te shqiptarët, ashtu dhe te grekët e sllavët, edhe pse murimi pranohet si i yni. Kujtojeni Urën e Shenjtë, Rozafatin...

Rasti i Lasgushit me Emineskun dhe zhurma rreth përkimeve të tyre bëhet edhe për arsye të tjera. Krijuesi i formatit të Lasgushit pengon ata, që janë nën hijen e tij, ndërsa degëzimet e tij në poetikën shqiptare sa vijnë e shtrihen. Gjeneri i tij është i një gjeniu e jo i ndonjë matrapazi, që ngritjen e sheh në rrënimin e vlerës. Nga leksiku i shqipes voli maksimumin dhe pasardhësve ua tregoi udhën; se fjala është ajo që bën çudira në ngrehinën e poezisë. Nëse Eminesku paska shkruar për gjenin krijues, liqenin apo për ndonjë motiv nga lashtësia hinduse, bën të shkruajnë dhe të tjerët. Gjeneri mbështet avancimin e ideve, e mesazheve; elaborimin e vazhdueshëm të motiveve e formave, dhe mbetet ajo që është më e arritshmja.


Megjithatë, në përkime ekzistojnë nuanca të theksuara që i dallojnë krijuesit. “Eminesku me përkushtim rumun dhe

universal me art, disi kështu”, - thoshte Tudor Argjezi. Ndërsa Lasgushi është diç tjetër, latues i vargut dhe më ëndërrimtar; ka një artikulum të veçantë për problemet njerëzore dhe artin, mbetet një bashkëkohës. Edhe pse dy poetë përkojnë në ca poezi, janë individualitete të veçanta e të dy janë të paarrtshëm.

Rreth origjinës së Emineskut ka supozime të ndryshme. Quhej Mihal Eminoviç. Sufiksi viç nuk është karakteristik për rumunët e më së paku parashtesa emin. Në një shkrim të vetin, Mitrush Kuteli thoshte se ky më së paku është rumun, edhe pse kritika kishte nisur ta quante: Eminesku është Rumania. Nuk mbahet mend t'i jetë bërë një nder i tillë ndonjë krijuesi. Kjo është çështje rumune. Por mbiemri i tij Eminoviç mundëson që të kërkohet origjina në Dardani. Kuteli e kishte zbritur në hapësirën shqiptare. Ekziston kjo mundësi, sepse shqiptarët mërgonin dhe shumë nga ata bënë emër në mjedisin e ri. Ndërrimi i mbiemrit ndodhi, sepse Eminesku dukej më bukur, një lirim nga sufiksi, që ndoshta përkujtonte të kaluarën e tij.

Pa marrë parasysh nëse është i anës sonë apo puro rumun, Eminesku nga leukonia e mediokërve përjetoi sharje të mëdha. Kjo ndodhi për shkak të xhelozisë dhe famës së tij që gëzonte jo vetëm në Rumani. Përndjekja vazhdoi derisa e çmendën. Dy vjet më pas Rumania humb njërin nga poetët më të mëdhenj.

Tek i dëgjoja shqirrjet rreth gjenialitetit të Lasgushit, buzë plazhit të Ilirisë, më kishte rrëmbyer valë deti dhe gati i ngjaja Martin Idenit të Xhek Londonit. Thellë isha zhytur. Nuk doja të dëgjoja paçavure mediokrish rreth një vlere kombëtare.



Vazhdonin t'i shikonin gjërat nga dritarja e tyre tepër e vogël. Megjithatë, ndërmjet këtyre dy poetëve ka diçka që i afron: identiteti.

Rrëtime vlerash ndodhën dhe te fqinjët veriorë. Vitet e 60-ta lanë zymtësi të rëndë në kulturën serbe. Poetin e estetin e njohur Branko Milkoviç, i cili kishte fituar famë me veprën e tij, kopeja e mediokërve e solli para aktit të rëndë: vetëvrasjes. Ishte shpërngulur nga Beogradi dhe mendonte se në mjedisin e ri do gjente qetësi, por ndodhi më e rënda. Në mëngjes herët me një litar ia kishte mësyrë parkut të madh të Zagrebit dhe me një cigare në gojë, pas dy orësh e kishin gjetur të varur. Ylli i tij ndrit edhe tani, por mediokrit nuk dëgjohen më.

Polemikë e rëndë kishte ndodhur dhe rreth origjinalitetit të librit me tregime *Varreza e Boris Davidoviçit*, e D. Kishit. E akuzonin se në tregime kishte inkuadruar ca fragmente nga një libër rus. Në të vërtetë, Kishi u shpaloste lexuesve shtetin totalitar që kishte shkaktuar tragjedi të mëdha njerëzore. Ishin, pra, inserte nga një botë e vdekur.

Ngjashëm mund të thuhet edhe për Kadarenë, shkrimtarin me famë, i cili ka merituar të nderohet me çmimin Nobel para disa emrave. Para se Kadareja ta shkruante romanin “Dimri i vetmisë së madhe”, atij i ishte dashur të lexonte një arkiv të tërë me dokumente dhe të gjitha procesverbalet e Konferencës së Moskës, ku ndodhi çarja mes shtetit shqiptar dhe Bllokut Lindor. Në një vepër ku hijon historia, nuk trillohen gjërat. Mediokrit nuk e kanë të qartë këtë. Kadareja ia kishte ofruar lexuesit kohën e morbiditetit ballkanas, atë errësirë e imazhit shqiptar.

Mario Vargas Losa thotë se me përcaktimin për ndërrime fillon dhe qytetërimi i vërtetë. Disidenti Adem Demaçi, fitues i shpërblimit “Saharov”, apelonte në ruajtjen e paqes, që ishte edhe pajtim kombëtar. Hasmëritë na sollën shpesh buzë varrit. Motoja e tij: jo atyre që rrudhin gishtin, por atyre që zgjasin dorën e pajtimit, ishte sinjal ndaj së keqes që kanosej. Ndërrimet vështirë të ndodhnin pa ndërrimin e mentalitetit. Ato që ndodhnin në hapësirë, ishin të dhembshme e tragjike. Në pyetje nuk ishte vetëm ekzistenca e një populli.

Para teje vështirë të ngrihet mjegulla. Pakëz gjë sheh se çfarë ndodh atje poshtë. Prapë merr të lexosh “Tunelin” e Sabatos. Dikush të kujton se e keqja nuk mundet me të keqe. Lirohu, pra, nëse mundesh nga mentaliteti. Kjo përshtypje lexohet apo dëgjohej për ndonjë kronikë të zezë. Më tmerron ajo që e shoh e nuk është plagë. Vazhdoj të bindem se gjendem diku në tunel dhe varet nga unë se kur do ta lë.

Përpara ke një monstër të së keqes. E lexon: nuk bën të përsëritet. U lë mesazhin brezave. Autobiografia e krijuesit është dhe autobiografia e popullit. Këtë e heton, se nuk je më vetëm i vetvetes.

Ngrihet edhe problemi i së ardhmes. Nga frika e së kaluarës vështirë të parafytyrosh të nesërmen. Libri kombëtar vazhdon të shkruhet. Problemi tjetër: kur të kryhet libri, e ardhmja do jetë ajo e ëndërruara?

Vrasja e një intelektualit na kujton se e zeza mund të të gjejë edhe ty, apo thirrjet: koka – vota. E sheh se gjendesh në tunel. Fije drite nuk di a sheh. Ndërrimet, për të cilat flet Mario Vargas Losa, vështirë të pranohen për shkak të sedrës. Njeriu ynë ndryshe predikon e ndryshe vepron. E sheh se edhe në atë që ke besuar, ta thotë një hipokrit. Të vjen të vjellësh e të pajtohesh, se mentaliteti është i tillë, vështirë të ndodhin ndërrimet. Ndoshta këtë do e kuptojmë, se vrasjet janë një tjetër robëri: dyshimi.

Misteri i vrasjes së Mehmet Shehut: i vetëvararë apo i vrarë, mbetet çështje e ndërgjegjes së shtetit ideologjik. Në librat e të birit, Bashkim Shehut vështirë t'i bihet



në gjurmë. Turpin ua la atyre që e bënë krimin dhe tragjedinë familjare e depersonalizoi: diktatura nuk rrënoi vetëm majat e veta. Ishte njëfarë asgjësimi i vetvetes, i cili na përsëritet shpesh, se ne vetë kontribuonim në të keqën. Pse të vritemi? Pastrimi ideologjik në veprat e Bashkim Shehut lexohet, para së gjithash, si dramë kombëtare dhe si flakje e së keqes për ndërrim.

Faik Konicën e çmuan më shumë të huajt. Shteti ideologjik e kishte përzënë, të themi nga të gjitha trojet tona, pasi vështirë pranonte “enciklopedinë që ecën” (Gyom). Ai frikësohej se guximi i tij qytetar mos bëhej lektyrë e të menduarit tonë. Duke parë se ku rrëshqasim, pajtohem edhe me sjelljet e fjalorin e tij, megjithëse nuk e kishte derdhur tërë vrerin. I kishte lënë shqiptarët të bëjnë gjumë të rehatshëm, në një kohë kur lypsej një vetëdijësim më i madh. Siç duket, ne mungojmë vazhdimisht, kur nuk duhet.


Fjalët e mëdha janë zbrastësi. Dëgjohen edhe në letërsi, në politikë dhe në fjalorin e përditshmërisë. Është mirë të distancohen, se shpesh mbjellin fatkeqësi. Kur i dëgjoj, më kujtohet një bekri: më mirë të më ruajë Zoti se rob, thoshte, bile Zoti e di kur duhet me të të ik.

Mund ta priste festën pa i marrë erë rakisë. Shpesh kishte shaluar qen varresh. Kishte hedhur anash receta e këshilla mjekësh. Kishte zënë vend mes miqve: gotë pas gote. Dikur u kishte kërkuar falje për çdo të keqe. nëse u kishte bërë. Në një vend më solemn të sallës ishte shtrirë dhe kishte dhënë shpirt. Miqtë ia kishin vënë te koka shishen me raki dhe një gotë. Ishte ndarë nga të gjallët, i përbuzur nga injoranca, një qejfli i pashoq i bohemi shqiptarë që nuk kishte pranuar të jetojë gjysmë i vdekur e gjysmë i gjallë...

Prapë fillon ta lexosh “Tunelin” e Sabatos, arbëreshit të urtë, i bindur se gjendesh diku aty. Dëgjon ndonjë klithmë dhe nuk i përgjigjesh. Nuk pranon ta ndërpresësh leximin, se nuk ke fuqi të ndërrosh asgjë. Por ndërrimet janë të domosdoshme për akcilin popull, se shpijnë përpara. Andaj të pajtohem me poetin roker Peter Gabriel: Çfarëdo që bëni. nuk mund ta ndalni lindjen e ardhshme...

Politika është art që mashtron. Vokacioni im është diçka tjetër, nuk më lejon të ndëshkoj njeriun. Brenda mundësive ndihmoj proceset që vënë diçka në lëvizje. Babai im më thoshte se nuk është mirë të përzihesh në zanatin e primitivëve dhe se dhuna nuk nderon askënd e më së pakti atë që e shkakton. Bën të mbetet liria “vetëm në librat shkollorë”? – pyet poeti roker, Jim Morrison. Një pyetje të tillë bën t’i përgjigjen ballkanasit. Ndërsa Europa rropatet të shuajë hasmëritë mes popujve e shteteve dhe liria të dalë nga librat e të bëhet realitet i të gjithëve. Kësaj iniciative bën t’i bashkohen ata që e duan lirinë e që nuk frikësohen nga pavarësia e akcilit popull, apo ta modifikojnë edhe më dhunën? De fakto formimi i shteteve nacionale vonon, askush nuk pranon të bëjë koncesione. Me përfundimin e marrëzisë në Gadishullin tonë nuk do të mbyllet liria në libra. Tek atëherë do fillojë bashkëpunimi e respekti mes shteteve e popujve të liruar nga ankthi: se dikush u rri mbi kokë dhe ua kërcënon lirinë e sovranitetin, pra në pyetje është paqja jonë.

Pavarësia e Kosovës nuk e frikëson njeriun e mençur, i tmerron “dizajnerët e krimin”, siç do të thoshte një poet, Roger Waters, ata që nuk mund të



heqin dorë nga hegjemonizmi e nacionalizmi i verbër: të rrënohet çdo gjë që nuk është i gjakut tim. Pavarësia mund të frikësojë dhe ndonjë përfitues vendor, se në kaosin kombëtar e rajonal sheh ngritjen e vet.

Çështja mbetet te mbrojtja e pakicave, gjë që dëshmon për etikën e shteteve që i marrin në mbrojtje. Në lagjen time në Gjakovë nazistët kishin tubuar dhjetëra hebrenj në fund të Luftës së Dytë Botërore: prinin t’i bartnin në Veri e që fqinjët veriorë me trena kafshësh i përcillnin për në Aushvic, numri i të cilëve nuk dihej. Qyteti im gjendej mes dilemave. Një ushtarak iu ishte drejtuar atyre që gjendeshin në mbrojtjen e të gjoëve: Zotërinj këta nuk janë minj, por njerëz...

Ballkani nuk bën të zgjohet mbi varre e gjak, që shpie te një katastrofë njerëzore. Përcjell masmediat dhe në shumë tekste që has, kam bindjen se vrasësit janë lodhur; se koha e çizmes ikën dhe ballkanasit duan të ndërtojnë secili shtëpinë në mënyrën e vet. Kjo është inkurajuese, se popujt krijojnë mozaikun e tyre shpirtëror, si dhe të etniteteve. Është qeniesore, se rajoni ynë nuk pranon të mbetet bisht i askujt. Ballkanasit harxhuan edhe fuqinë e paktë që kishin për të ekzistuar.

Pranimi i sovranitetit dhe ekzistencës mes shteteve është fitore e të gjithëve; pavarësia e akcilit popull shpie te pavarësia dhe shpëtimi nga ankthi makbethian. Me pushimin e smirës dhe gjakderdhjeve, popujt do vlerësohen e respektohen përmes kulturës dhe vlerave nacionale. Krenohem që ballkanasit dhanë krijues të mëdhenj; t’i kujtojmë Homerin, Eskilin, Aristotelin, pastaj Herodotin, i cili thoshte: të hapësirës sonë janë dy popujt më të vjetër, Helenët dhe Ilirët. Në momentin e tanishëm kjo duket utopi, por njeriun duhet ta gëzojë liria, përndryshe na pret ndonjë humnerë e re.

Shkaktari i hasmërive qëndron te krijimi i vonshëm i shteteve nacionale dhe gllabëruesit që bënin çmos të shtrihen në dëm të tjetrit. Po qe se lirohemi nga kjo çmenduri njerëzore, nuk do të frikësohet kush nga pavarësia e tjetrit, se liria bëhet realitet.

Kavafisi, poeti im i respektuar, “njëri nga lirikët më të mëdhenj të parnasit neogrek”, siç thotë Kostas Varnalis, ndryshe do shihte zgjimin e popujve dhe të shteteve me atë buzëqeshjen e tij të hidhur në buzë...

Tatëpjetë golgotës zbriste një hije njeriu, ai ishte çami, këngëtar i verbër i Sulit.

## Festivali i letërsisë “Polip”, 40 shkrimtarë mblidhen në Prishtinë

Festivali ndërkombëtar i letërsisë “Polip”, që mbahet në Prishtinë dhe këtë vit nis më 10 maj, hyn në edicionin e 9-të, duke mbledhur rreth 40 shkrimtarë e artistë. Këtë vit “Polip” fokusohet në nocionin e ‘ujdisë letrare’ dhe botëkuptimeve rreth saj si një proces negociator artistik që u mundëson shkrimtarëve e artistëve ballkanikë që (vetëm) me veprat e tyre të shpërthejnë kufijtë e t’i plasojnë vlerat letrare në pjesët e “zhvilluara” të botës. Rreth 40 shkrimtarë e artistë të stripit e romanit grafik, nga rreth 20 shtete të ndryshme të botës, do të marrin pjesë sivjet në këtë edicion të radhës të festivalit polip dhe në edicionin debutues të Festivalit Ndërkombëtar të Romanit Grafik – GRANFest, i cili po ashtu fillon këtë të premte. Ndër mysafirët e shumtë, sivjet do të vijnë edhe: Besnik Mustafaj nga Shqipëria, Sreten Ugricic nga Serbia, Tom Kaczynski nga Amerika, Lindita Ahmeti nga Maqedonia, Tanja Raich nga Austria, Olga Grjasnowa nga Azerbajxhani. “Procesi i marrëdhënieve është i pandalshëm. Festivali “Polip” sivjet po i mbush dhjetë vjet që nga edicioni i parë në vitin 2010, i organizuar nga dy grupe të pavarura letrare nga Beogradi dhe Prishtina. Ai tashmë i ka tejkaluar kornizat rajonale”, – thuhet në editorialin e sivjetshëm të festivalit. Këtë vit, përveç mbrëmjeve të leximit, “Polip” sjell edhe diskutime mbi letërsinë e artet. Në panelin e parë “Epoka e opinioneve” që mbahet të shtunën, do të diskutojnë të ftuarit Melinda Nadj Abonji, Olga Grjasnowa, Besnik Mustafaj e Robert Prosser. Po të njëjtën ditë mbahet edhe paneli i radhës, “Ujdia letrare – Rruga revolucionare”, me të ftuarit Veton Surroi e Sreten Ugricic, me moderator Sasha Iliqin. Në panelin e tretë, të dielën, do të flitet mbi temën “Informata kreative kundër asaj manipulative” me të ftuarit Fumio Obata, Dave McKean, Sarah Hehir, Ville Ranta, Tom Kaczynski e Marcello Quintanilha, kurse moderohet nga Gani Jakupi. Paneli i fundit “Paralelni polis – një koncept disident që e ndjek të tashmen”, mbahet po ashtu të dielën dhe diskuton me të ftuarit Alida Bremer, Lena Dorn, Marek Šindelka e Shkëlzen Maliqi, moderohet nga Matteo Colombin. Të shtunën, nga ora 20:00, mbahet një “Homazh për Bekim Lumin”, në të cilin aktorë kosovarë do të lexojnë për herë të parë poezitë ende të pabotuara të regjisorit tashmë të ndjerë Bekim Lumi. “Polip” e GRANFest këtë edicion kanë organizuar edhe programin plotësues në Prishtinë, Prizren e Graçanicë, ku do të organizohen orë leximi, ekspozita të novelës grafike e sesione diskutimi mbi letërsinë e krijimtarinë letrare.



“

Politika është art që mashtron. Vokacioni im është diçka tjetër, nuk më lejon ta ndëshkoj njeriun.



# NJË RRAPËLLIMË ENERGJISH

Nga Daniele Pantano

## VIZITA DHE DARKA E FUNDIT PARA PUSHTIMIT TË CILIN VETËM NE E DINIM

Më në fund. Ëmbëlsira. Ai hapi  
Grilat dhe shpaloj  
Gjithçka që do të rreshtte  
Së pasuri rëndësi ditën tjetër. Rruginat  
Ku burrat po luanin një tjetër  
Lojë shahu – vë theksin barabitsëm  
Mbi kohën dhe gratë që parakalojnë  
Si pemë limoni në një treg hurmarabish.  
Pabe. Këngë. Tempuj adhurimi.  
Jo. As jetimorja, madje as  
Gjinjtë e nginjur të gruas së tij shtatzënë  
Nuk do të kishin rëndësi. Mikpritësi im nguli këmbë  
Që kohën ta kaloja duke shkruar të rëndësishmen,  
Jo të bukurën. *E ç'tjetër mund të bëjmë?*  
Pyeti ai. *Të vazhdojsh*, ia ktheva.  
Dhe kërkova falje për veten. Për të gjithën.  
Përveç pjatës sime të papastruar:  
Rrota limoni dhe qumësht i derdhur.



## FUGË

Nata korr aromën e saj. Gjymtyrë të shpaluara:  
kaligrafi joshjeje.  
Nomadët pëshpërijnë gjashtëdhjetë e nëntë kufij.  
Akord lëkure. Çdocili përshkon  
Një rrapëllimë energjish. Çdo depërtim një zgavër  
ngushëllimi.

## DUART MË TË VJETRA NË BOTË

Në këtë karrige, sikundërse çdo mëngjes, kur pres  
Të më sjellin kapuçino e briosh,

Dhe vajzën me duart më të vjetra në botë,  
Ndiej se mërgimi është një qytet i lartësuar nga artifica  
e përjetshme.

Gjithë dhunë të ëmbël dhe mendim dhe përsëritje.

Përtej çka historia la pas në këtë topografi,  
Filxhani është bardhëllimë, kafja spermë (farë) e  
murrme.

Rrufitja ime e parë e shfaq atë bashkë me hajet  
(ushqimin)  
Dhe sandalet pas rrënojave të parëndësishme.

Por në çastin që flasim, rrënojat janë pemë eukalipti.  
Dhe ajo jo një vajzë që shkon të ushqejë pulat

Por veç një fytyrë e fshehur nga rrjetat që kullojnë.  
Veshur  
Me vela të zeza dhe flokët lyer me një bionde romake.

Buzët e shpirtit të saj janë sherebelë që djeg, e di.  
Emrin, jo. Vetëm duart e saj kanë rëndësi.

Cit me shenja të gropëzuara, më ndërmendin –  
Se shtëpia është aty ku fëmijët mbijnë në truall të  
valëzuar.

Ku gjurmët janë mozaikë të mundësisë.

Me vazhdue. Me mbarue mëngjesin. Me lexue rreshtin  
Që mbaron në frymën e Zotit. Sërish.



**Daniele Pantano** është poet zviceran, përkthyes letrar, kritik dhe botues. Poezitë, esetë, përkthimet dhe kritikate e tij janë botuar dhe përkthyer gjerësisht në shumë gjuhë: shqip, bullgarisht, gjermanisht, frëngjisht, persisht, rusisht dhe sllovenisht. Veprat e tij të fundit përfshijnë përkthimet: Robert Walser: Komeditë (Seagull Books, 2018), ORAKL (Black Lawrence Press, 2017), Përrallat e Robert Walser-it: Dramoleta (New Directions, 2015), si dhe Qentë në fushat e djerra: Poezi të zgjedhura nga Daniele Pantano (Wolfbach Verlag, 2015). Pantano ka dhënë mësim në South Florida University, ka qenë poet në rezidencë në Florida Southern College, si dhe ka drejtuar programin e shkrimit krijues në Edge Hill University, ku ka qenë profesor i lëndës lexuesi i poezisë dhe përkthimi letrar. Aktualisht ai jep mësim në University of Lincoln.

## ME FIONËN, 2 VJEÇE, NË KOPSHTIJE

Të shijon si askurrëgjë bota e pafund e perceptimit.  
Arrin të dallosh rrënjën e të shfaqmes.

Bën para me siguri dhe shkujdes. Reagon ndaj tij  
nësa kthehesh të vëresh vështrimin tim të paditur.

Ta dish që shikimet e tua përbashkojnë takimin tim  
me thelbin e ekzistencës.

Streha ime prej kohës e dijes: shkenca  
e pinjovje kopilë të jetës.

Jashtë binte shi dhe çatia pikonte.

Baptima e hapave të një njeriu që afrohej drejt  
ahurit, teksa tërhiqte zhakthi një tjetër, e bëri Lefin  
t'i rrihte më fort zemra. Pastaj, kur dera e ahurit u  
hap duke bllokuar atë të qilarit, ai ndjeu dihatjen  
e rëndë të një mashkulli, kërcënimet e tij si dhe të  
qarën e mbytur të Danjushës, teksa i lutej të huajit që,  
për hatër të Zotit, ta falte.

Vetëm një metër larg, matanë murit që i ndante,  
i huaj shfryu gjer në fund epshin e tij mbi nusen e të  
vëllait.

Lef Kukës erdh' e iu rëndua aq fort zemra, sa iu bë  
si gur i thyer varri. Kurse frika, gjithnjë e më tepër, si  
një merimangë e madhe skutash të errëta vazhdonte  
ta mbështillte me fije të holla e të forta, derisa ai e pa  
veten të mbyllur si krimbi brenda pezhishkës.

Pastaj barbarët i nxorën nga ahuri të gjitha  
bagëtitë: kalin, dy qetë, lopën si dhe tufën e deleve.

Pak nga pak, zërat e tyre urdhërues dhe klithmat  
e banorëve të pafajshëm erdhën duke u fashitur.  
Atëherë atij iu ndez një shpresë që Zoti vërtet ia  
kishte dëgjuar lutjen dhe dera e qilarit nuk do të  
hapej.

Kur nata iku bashkë me tmerret, ia behu

# FRIKA

Tregim nga Ramiz Gjini

Kur barbarët u dhanë në portën e madhe të oborrit  
të Lef Kukës, ky i fundit doli nga dera e pasme  
dhe arriti të futej e të fshihej në qilar.

Qilari qe ndërtuar ngjit me ahurin e bagëtive dhe  
hyrjen e kishte disi sekret. Kur hapej dera e ahurit,  
fleta e derës bllokonte atë të qilarit.

Për të hyrë në qilar, duhej të hyje pikësëpari në  
ahur, pastaj të mbyllje derën. Por edhe atëherë, për  
njerëz që nuk e dinin, qe vështirë ta gjenin hyrjen,  
pasi brenda ishte gjithmonë errësirë e plotë. Për ta  
mbrojtur ahurin nga hajdutët, dy dritaret qenë zënë  
me plitharë dhe nëse dera ishte e mbyllur, asnjë rreze  
drite nuk depërtonte aty brenda.

Lef Kuka u struk i fshehur në qoshen më të  
errët, prapa një vozi vere. Sipër vozit gjendej lëkura  
e tharë e një lepuri të madh, të cilin ai e pati vlarë  
vite të shkuara. Asokohe, – kishte qenë e premtë si

sot, – ai qe kthyer nga kodrinat me gjahun mbi sup,  
e kishte ulur në tokë mu në sheshin e katundit dhe  
ua kishte treguar të gjithëve sa u ndodhen aty, duke  
demonstruar një krenari prej gjuetari me zotësi të  
madhe. Dhe kishte hak: askush në katund nuk pati  
mundur të vriste një lepur kaq të madh sa ai që vrau  
Lefi.

Tashmë, i fshehur prapa vozit, ia ndjeu asaj  
lëkure erën e gjakut të tharë dhe i erdhin për të vjellë.  
Kurse nga jashtë atij i kapi veshi britmat e çjerra  
të Danjushës, nuses së vëllait, para së cilës barbarët  
shkonin në thikë të shoqin e saj, Gjeggjen, – vëllain e  
vogël të Lefit.

- Jam në vatanin tim, - u thoshte Gjeggja të huajve.  
- Në shtëpinë time...

Në vend që të dilte, Lefi u rras edhe më tepër në  
skutën e errët dhe ra në një gabim fatal, për të cilin, jo  
në këtë jetë, por në atë tjetrën, do të pendohej rëndë:  
iu lut Zotit që të mos hapej dera e qilarit.

Pastaj zëri i të vëllait erdh' e u shua derisa shpirti  
i tij u ngrit në qiell.

Atë çast, dikush e pështyu në kokë Lefin.

Kur ktheu sytë lartë të shikonte kush qëndronte  
mbi trarët e tavanit, një tjetër pështymë i ra në fytyrë.



## MES STACIONEVE TË METROSË

Sa mrekullisht bëhet njësh gjithçka me degën e zezë:  
Këmbën e saj artificiale që e lëkund si të njëmendtë.  
Gishtat e kërryer  
Në mjekrën e tij dhe imazhet e harruara që i ndërmend.  
Një ngërdheshje vogëlushi kapur për mollëzash.  
Grushte. Të thjeshtë  
E të pacenuar, njashtu si fantazmat që ndajmë  
Çdo mëngjes, *en passant*, nga kreshtat e nisjes  
Drejt çfarëdo gjëje që besojmë të mundshme. Sa për  
të qeshur.  
Sa për të qeshur kur mendojmë se të gjithë rishfaqemi  
si petale –  
të zmadhuar. Të mohuar prej çka na mbrojtë nga shiu.



## RRUGË QË MBAROJNË ME EMRIN TËND

*Qyteti s'ka me e mbajtë mend emrin tënd veçse përvëçse në  
rrugët e tij.*

Por rinia i zhgropos emrat e vet si faqe të grisura  
Nga një libër i ndaluar: album-kolazhe njollash.

*S'mund t'ia lejojmë këtij qyteti të na shpërfillë.*

Shurrojmë emrat tanë në muret e katedraleve.  
Shohim se si shkronjat kullojnë përmes historisë.

*Kur nata të ketë prekur plagët e veta, askush s'është më i  
panjohur.*

Prej poshtë harkadës së rëndë, përzhitim  
Hartat tona. Mbjellim hi për të Humburit.

*Gjithçka është e njëmendtë; asgjë s'mund të vidhet.*

Zërat tanë të pakëmbë thyejnë një vijë të panjohur.  
Një degë që thyhet përmes dyerve të vjetruara.

*A je lënduar? Eja dhe shihe nga afër.*

Ngjiti muret më të larta. Qëndro. Pi një tjetër  
Shishe. Flake. Shihe ndërsa bie. Vajto ndërsa  
thërrmohet.

*Përktheu: Elvana Zaimi*

mëngjesi. I paqtë e me një diell të shndritshëm, që  
i bëri gjallesat të zhurmonin hareshëm. Jeta gëloi  
natyrshëm si rrjedha e një uji të ëmbël që del nga  
nëntoka për t'iu kthyer edhe njëherë bimësisë nga  
rrënja në gjethe.

Lef Kuka provoi të lëvizte, por kurrësi nuk  
mundi. Nuk kishte as këmbë, as dorë, madje as  
edhe një muskul në trup që të mund ta vinte në  
lëvizje.

Sa shumë deshi atë botë Lef Kuka që të vinin  
ta gjenin.

Kushedi sa herë ai dëgjoi hapa dhe zëra njerëzish  
që i njihte. Madje, në një rast ata hynë edhe në ahur  
për të parë mos kishte mbetur aty ndonjë bagëti,  
por as që e morën mundimin për të hapur derën që  
të fuste në qilar.

I dërmuar shpirtërisht, atij iu pak aq shumë  
fryma brenda pezhishkës, sa nuk mundi të nxirrte  
as edhe një tingull nga goja.

Dhe kur koha rrodhi e zërat erdhën duke u  
dëgjuar gjithnjë rrallë e më rrallë, vetëm atëherë ai  
u kujtua që i ishte lutur Zotit të mos hapej ajo derë.

Dhe mbylli sytë që të vdiste.

PEIZAZH ME  
HËNË

Nga Rudina Çupi

## PEIZAZH ME HËNË

*Hape gojën si rrjetë fluturash e gjuhën ma rrëmbe!*

Kam një vend për ty:  
eja shpëto nga të gjitha hijet e ditës!  
Ejmë në gojë  
dhe me çokollatën prej gjuhe që shkrin  
e bëhet bojë-e-penel,  
zbulo se goja është peizazh për dy vetë;  
ec e përkëdhel  
zbulo stolat e bardhë e vënë qark si në skenë  
dhe një teatër të butë shtrat në mes...  
e sheh?  
ka errësirën e duhur për dashuri,  
e më tej  
nëse gjuhën-fjollë e çon të zbulojë siç di  
do shohësh se ka një orkestër në grykë  
që notën e parë të rënkimit luan në sol maxhor  
mos ndalo...  
ngjitu e shih se ka një kubë të harkuar qiellzë  
sa nxë gjithë qiellin e pasqyrtë me vesë;  
futu e zbulo  
motin e të gjitha tangove të poezisë,  
që kondensohet e rrjedh cepave të buzëve si pjalm  
si lëngu i hënës së ngrënë, sapolyer me ar(t).

KUJTIMET<sup>1</sup>

*I dua dritaret me kanate  
si duar të hapura për përqaftim - të gjera sa një oborr me  
lule.*

Mbështillem me krahët e mi...  
për të ndier me mend praninë tënde,  
e shtrëngoj aq fort atë përqaftje çapitëse  
sa ndjenjat plasën si njolla të errëta në sy  
e zbresin si vesë mbi buzë te një puthje petali;  
hija e këtij vallëzimi në mur është njëjës, e hollë  
si një fyt i ngushtë për të marrë frymë  
kur lotët përmytin ajrin me avull,  
sytë e xhamat vishen me mjegull;  
në këtë dhomë të mbyllur si gonxhe  
banuar vetëm nga molat e kanateve  
që brejnë drurin, në simfoni me molat e mia;  
unë e shoh qartë e thellë mallin prej mëndafshi;  
në këtë dhomë pa perde-petale-që-gëzohen-në-erë,  
ku endem si gjysmë tape  
mbetur brenda shishes përgjysmë me verë  
ndiej bulëza dhe bëj rrathë të mpirë lëngjesh  
që përplasen prapë tek unë si një ishull lundruar;  
për t'u kalamendur në këtë vallëzim të përgjysmuar  
psherëti me rrokje - si puls - emrin tënd në vend të  
melodisë...

Sa lehtë do ta mbanin peshën këta gjunjë të kapitur,  
kur faqet t'i puqnim pashqitshëm  
si mollëza gishtash të ngjyer në mjaltë!

1 *Kujtimet janë si ujgërit. Nuk mund t'i kyçësh diku e të  
shpresosh që ato të harrojnë të të kafshojnë.* Nina George.

## FËMIJA IM UJOR

*Fëmija im ujon, krejt bardhor,  
Lirinë tani ti përhap si syprinë tej-e-tej mes brigjeve-  
plazhegjera  
shtrirë me shpinë, tek luan me lodrat e qiellit e anijet me  
vela,  
i trazuar, i përhënur, i dettë.*

Kur brigjet të të marrin, të të afrohen e të të afrohen  
si kërcënim  
të të shtypin e të të hollojnë si lumë,  
fëmija im i lëngët, mos u anko e as mos bubutij,  
lotët do të të çkripëzojnë,  
do të ndihesh ujë i ëmbël siç janë të gjithë lumenjtë  
i rrjedhshëm nëpër një shteg  
dhe, për ironi, mallin e anijeve të së shkuarës  
do t'ua rrëfesh trungjeve që mbart mbi shpinë.

Mos mëso të mallkosh, biri im i ujshëm,  
kur të mekesh si dëborë e të tretesh si avull mbi xham  
apo tek kalon mes dy pllakave të tokës aq ngushtë  
sa mes dy duarve të puthitura për lutje,  
atëherë kujto se ke fatin t'i lësh...  
ndaj lëri e lëri vazhdimisht  
e udhëto për të zbuluar forma të reja të vetes nën  
shtypje  
derisa të kuptosh forcën e qindrafishuar që ke brenda  
vetes  
për të gdhendur shkëmbinj nëntokësorë  
për ta gjetur rrugën tënde me thonj  
derisa ta shpikësh një të çarë për të gjetur dritën  
dhe të shpërthesh, i mahnitshëm, i epërm, ylberor, si  
një ujëvarë,  
duke mbretëruar me kurorën e mjegullës  
si një mjellmë me aureolë.





Në një hark kohor dyvjeçar, poezia e Faslli Halitit dominoi sistemin letrar me tharmin e guximit qytetar, deri në kufijtë e teksturës së protestës, si në poemën “Dielli e rrëketë”

# FASLLI HALITI REALITETI DHE “NXIRJA E REALITETIT”

Nga Leka Ndoja

Poezia e Faslli Halitit paraqiti që në fillimet e tij një mision social të ngritur. Ky komponent që e ka veçuar poezinë e Halitit si të shënjuar të rëndësishëm, mori formë nëpërmjet diskursit dhe regjistrit të nderë të mezidallueshëm nëpërmjet deklarativitetit, që nëpërmjet marrjes së intonimit të paplotë ose në sordinë të poezive *plakat* në “thonjëza”, prodhojnë një perceptim që poezia e Halitit të mund të receptohet me regjistrin komik. Receptimi i kësaj poezie në dukje, nga ana e klisheve ishte korrekt me realitetin zhurnalistik të formave e klisheve shprehëse që i bënë të sillen si figuracion artistik nëpërmjet këtij regjistri-bazë të përcjelljes së mesazhit poetik. Duke shpërdorur mjetet e thjeshta verbale të propagandës komuniste, Haliti arriti me shkathësi t’u jepte teksteve një komicitet e pabesueshmëri, falë drejtpërdrejtshmërisë së përcjelljes së mesazhit nëpërmjet manierës “naiv”. I kësaj linje ishte një cikël i tërë i këtij poeti kushtuar pak a shumë qendrës së superstrukturës politike të shtetit, siç ishte shembulli i poezisë së famshme “Një natë me sekretarin e Partisë”: *Prozhektorët e fjalëve të tij/ Më ndriçojnë dardhat, mollët, pjeshkët/ Që nata m’i ka fshehur/ Më zbulojnë ngjyrat, tonet/ Që nata i ka shuar.../ Biseda jonë një oficinë/ Këtu kaliten vargjet e mia*. Kjo poezi, si ekspresion i nevojës së subjektit për një lider që të njohë botën, ravijëzon sekretarin si idol, koncept i drejtimit politik. Repertori i *dardhave*, *mollëve*, *pjeshekëve*, simbolizon një lloj briri prosperiteti të cilin s’e siguron dot pa sinekdokën e dritës; simbol i udhëheqjes së “Partisë”. Gjithashtu, regjistri i intonimit i siguron edhe “forxhën” (oficinën) e Hafestit antik, hyun e artit. Mistifikimi i rolit të sekretarit në natën e së panjohurës, i cili flet para dëshmisë së yjeve, dhe përvoja e subjektit, konfigurron një skenë varësie dikotomike, thuajse fatale. Por me uljen e regjistrit, nga toni epik në atë komik, situata poetike ndryshon dhe skena

kthehet në karikaturë, duke goditur kolonën e gjithëdhijshme të mbajtjes së shtetit komunist, sekretari pasi vihet në funksion lumineshence, i mbetet poetit të ndajë me të errësirën, si simbol qesharak varësie. Si një nga kryeveprat e këtij poeti, që arriti të kumtojë përmes kodeve e simboleve të tjetërsojta, kuptimin e ngulitur të receptuesve të kësaj teme. Në momentin kur Haliti vendosi ta heqë këtë regjister komik dhe të fshikullojë drejtpërdrejt përmes motiveve social-politike duke larguar “errësirën” komike si te poema “Dielli dhe rrëketë”, kritika zyrtare ia ndërpreu vlerësimin duke e quajtur art armiqësor, pasi ishte univok.

*Portat e buzëve tua s’hapeshin  
Hynte pa trokitur.  
Dhëmbët tua kyçeshin...  
Vinte miqësia hynte pa trokitur.*

Poezia e Halitit u fokusua në raportin e intonimit të civateve-fragmente në kuadër të tekstemave ku subjekti krijon regjistrin që merr atributet e publikut të gjerë, të masës. Ai i kapërceu mjaft barriera të censurës, pasi tek ai skizma nuk shquhej në tekst, skizma e Halitit dallohej te poetika e intonimit. Poezia e Faslli Halitit e riprodhon realitetin në thonjëza, kjo është veçoria e këtij poeti që risolli mjetet revolucionare të Majakovskit me të vërtetë, por e ndërtoi mbi një regjister komik, për ta stigmatizuar fenomenin e zbrazur, “marksizmin vulgar” nga tonaliteti amploz, duke e bërë qesharak përmes intonacionit të ulët. Poet me vokacion social, që me guximin e shprehjes ai linte pak alternativa të interpretimit, Haliti ushtronte trysni mbi theksin propagandistik duke e zhvendosur theksin e kuptimit duke e kanalizuar në një kuptim të përmbysur burlesk. Dykuptimësia e brishtë e poezisë së Halitit, me ta dekoduar, kalon në njëkuptimësi. Zbulimi i kësaj teknike nga Institucioni i Kritikës, ia dekodoi tekstet e Halitit, për t’u damkosur si “nxirës realiteti”. Sfida midis të folurit parodik dhe atij të njëmendtë mbetet çështje e repertorit të receptuesit. Analiza mbi këtë poezi do të bënte që kritikët të binin në grackën e tij, pasi nga ana formale ishte korrekt, por vetëm thonjëzat e bëjnë atë poet modernist.

## Një kod novator: regjistri komik

Rrafshi ironik i Faslli Halitit është shfaqur në “Një natë me sekretarin e Partisë”, se ai ishte një kodifikim i kontekstit, pasi çdo akt poetik ka diagramin e tij, regjistrin nga ai epik në atë komik. Duke cenuar temat tabu të demistifikimit të lidershit, motivet sociale vijnë e ia përmbysin lëndën poezisë së Halitit, derisa vetëm dialogon me argumente heteronome. Intertekstet



e poetikës së Majakovskit bartin interpretimin e hapur, kuptimin polimorf, ndërsa poezia e Halitit mbetet e profilizuar. Tematika e tij vetëm në ndonjë rast ikën nga vëmendja e diskursit social. Në një hark kohor dyvjeçar poezia e tij dominoi sistemin letrar me tharbin e guximit qytetar, deri në kufijtë e teksturës së protestës si në poemën “Dielli e rrëketë”. Me figurën e simbolit për “Diellin” - Nr.1, të partisë e shtetit, poemë ku shenja poetike e humbi polivalencën duke i shërbyer një aktakuze të vargëzuar, ku mbetet vetëm historia dhe fatumet morale në kundërshti me frymën e partisë në vitin 1973. Kështu Faslli Haliti nga një poet i vlerësuar për origjinalitetin e thjeshtësinë e mesazheve të drejtpërdrejta nisi të goditej në ballë të gjerë nga gjithë kritika zyrtare, për t’iu hequr për 10 vjet të drejtat e profesionit dhe të botimit. Se ku do të arrinte kritika e Halitit ndaj regjimit vetëkuptohet, pasi ai me stilin e tij të zgjedhur “primitiv” sillte virulencën e pastërtinë transindividuale, arketipin kolektiv, të njeriut të punës, të myzeqarit, duke bërë të vetat sintagmat e këtij arketipi. Poezia e tij u bë avokat e së drejtës që shkelej haptas, sidomos në provincë, si Lushnja e poetit. Ndërsa poezia tjetër e famshme “Djali i sekretarit” mbetet në kufijtë paradigmaticë të kuptimit, ku poezia paraqet proteza morale dhe sigmatizon një ves gjithëkohor si “servilizmi”, duke përdorur figuracion deri perversiv: *Pastaj vajzat tua do ta gjejnë shokun vetë! Ju jeni pleq.*

## Realiteti dhe “nxirja e realitetit”

Faslli Haliti, që pati ironizuar edhe herë të tjera në motivin e tij të profilizuar të “Sekretarit” si demiurg që ia ndriçon “konceptet e errëta” poetit të analizuar më sipër në Plenumin IV, hasi përballë një arsenal që ia kishin diktuar kodin e tij përtallës. Tashmë i “demaskuar”, militantizmi i tij u fut në thonjëza dhe vepra e tij u shua për dy dekada. Fryma e Majakovskit e kishte përfshirë shumicën e vargjeve të tij, si bie fjala: “Shokë. Krijoni një art të ri.” Vargjet e tij ndërtohen shpesh nga aforizma mendimi, nxjerrë nga kodi i së drejtës, por sipas reporterit të tij interpretohen si programe politike groteske. Kulti i së drejtës sociale e ka tronditur poezinë e Halitit, aq sa shpesh devijon misionin estetik... Librat e botuara nga ai në vitet 1997-2010, “S’di të hesht”, “Kaq” etj., kanë ende dimensionin etik të receptivitetit të viteve ’70.





# "HEBRENJTË NË SHQIPËRI", NJË LIBËR I MONIKA STAFËS QË ZGJON INTERES TË VEÇANTË

“Është pritur prej kohësh një libër për hebrejtë në Shqipëri. Nuk është e tepërt të theksohet se trajtimi i këtij problemi delikat do të ishte diçka e natyrshme për letrat dhe studimet kudo në botë. Qëndrimi ndaj hebrejve ka qenë dhe vazhdon të jetë një çështje globale, planetare. Kjo, për arsyen e qartë se ndërgjegjja e njerëzimit mbarë është vënë në provë.

Historia shqiptare ka një pikë takimi tepër të ndjeshme me këtë dramë botërore. Qëndrimi ndaj hebrejve, më saktë, mbrojtja e tyre, nga një popull me histori të zymtë, si i yni, që e nderon, në kuptimin më të madh të kësaj fjale. Është kjo një nga arsyet që libri i shkrimtares dhe studiueses Monika Stafa, “Hebrejtë në Shqipëri”, zgjon një interes të veçantë.”

Këto janë fjalët e shkrimtarit Ismail Kadare që shoqëron, me parathënie, librin “Hebrejtë në Shqipëri” të gazetares Monika Stafa, botimet “Onufri”. Sipas tij: “Në Shqipëri hebrejtë, siç dihet tashmë, historikisht nuk janë mbrojtur nga një pjesë e popullit dhe janë diskriminuar nga pjesa tjetër, nuk ka qenë problem i njerëzve të kulturuar që mund ta kenë bërë këtë gjë për arsye emancipimi dhe pjesa e paditur e popullit ka bërë disa herë të kundërtën, siç qëllon shpesh.”

“Nuk gjendet në Shqipëri asnjë dokumentacion i një grupimi politik ose i një lëvizjeje që ta ketë prishur këtë unanimitet. Prova e madhe, siç u tha, ka qenë Lufta e Dytë Botërore. Kjo është një e vërtetë e njohur. Këtu, ky unanimitet u konfirmua edhe njëherë. Shqiptarët nuk kanë pasur unitet gjatë luftës, rrjedhimisht, prova ka qenë e dyfishtë në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera. Sepse Shqipëria pati një keqkuptim të madh

politik. Forcat komuniste dhe nacionaliste u ndeshën në shumë probleme themelore që lidheshin me komunizmin apo me antikomunizmin dhe Shqipëria përfundoi pas pushtimit gjerman zyrtarisht në një shtet gjermanofil. Pra, me pozicionin e hebrejve

Monika Stafa

## HEBRENJTË NË SHQIPËRI

Me parathënie nga  
Ismail KADARE

Onufri



mund të ishin krijuar kushtet që të shpallej dukshëm si vend antisemit. Kjo nuk ndodhi”, - shkruan Kadare.

Libri është fryt i një pune disavejçare kërkimore dhe shkencore të studiueses Stafa.

“Hebrejtë në Shqipëri janë një komuniteti jo pak i rëndësishëm në mjedisin shqiptar, një mjedis harmonik në lidhje sa i përket minoriteteve. Teza vjen si një studim i mirëfillt shkencor, larg miteve të ngritura deri më tani për arsyet e shpëtimit dhe mbrojtjes së hebrejve prej rrezikut shfarosës gjatë udhëve të historisë, me theks të veçantë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Libri synon të hedhë dritë mbi ekzistencën e këtij komuniteti dhe arsyet e bashkëjetesës së harmonishme me shqiptarët. Qytetarë nga e gjithë Europa me shtetësi të ndryshme, por që i përkisnin kombësisë hebraike, gjetën shpëtim e mbrojtje në Shqipëri, duke e parë atë si një rast “sui generis” në mes gjithë atij kontinenti që kërcënohej prej terrorit nazist.

Vlerësimi i sfidave me të cilat Shqipëria u përball në një prej periudhave më të vështira që hebrejtë e huaj dhe ata vendas po kalonin në Europë (1933-1944), përbëjnë bazën analitike dhe kërkimore të këtij studimi. Fokusimi në marrëdhëniet e tyre me autoritetet vendore/ lokale dhe popullin shqiptar zë peshën më të madhe në studim, për vetë rolin që këto të fundit luajtën në shpëtimin e tyre ndaj rrezikut



shfarosës nazist”, - thotë Stafa. Sipas saj, në fokus të tij, ky libër ka pasur 5 çështje për t’u trajtuar, në pesë kapituj të ndryshëm.

Pjesë e punimit janë edhe parathënia, hyrja, konkluzionet dhe bibliografia. “Studimi është ndërtuar kronologjikisht mbi dy fazat më të rëndësishme historike dhe me ndikim të dukshëm në historinë e këtij komuniteti: faza e parë ka të bëjë me periudhën e Mbretërisë Shqiptare, për të vijuar me atë të Luftës së Dytë Botërore. Në tërësinë e tij libri synon t’u japë përgjigje disa pyetjeve. Përse hebrejtë iu drejtuan Shqipërisë, sapo u shpall doktrina famëkeqe “Final Solution”? Çfarë mundësish ofroi Mbreti shqiptar Ahmet Zogu dhe autoritetet qeverisëse të vendit ndaj tyre? Si vijoi ardhja e hebrejve gjatë pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste dhe përse ajo ndoqi një politikë survejimi dhe jo ndëshkimi ndaj tyre? Cili ishte qëndrimi i qeverivë kolaboracioniste ndaj hebrejve të rrezikuar që erdhën prej Jugosllavisë, Bullgarisë, Rumanisë e Maqedonisë? Si ishte sjellja e shqiptarëve ndaj hebrejve, kur vendi u pushtua nga Gjermania? Cilat janë veçoritë dalluese të Shqipërisë në raport me vendet e tjera, që u dorëzuan autoriteteve pushtuese gjermane listat me hebrej? Përse me hebrejtë e Shqipërisë në kushtet e një terrori të pashembullt në vendet europiane u ruajt një sjellje shembullore dhe rasti Shqipëri u shënjua si një ndër rastet më të paprecedent në historinë e popullit që kërcënohej për zhdukje masive? Çfarë ndodhi me ta gjatë luftës dhe pas saj? Hebrejtë në Shqipëri në vitet 1933-1946, është një çështje sa e studiuar, po aq edhe e pathelluar. Shënime të përzgjedhura mbi këtë komunitet gjenden në librin “Shqiptarët dhe hebrejtë në shekuj”, një libër me kërkime të mëhershme mbi këtë komunitet, të studiuesit Apostol Kotani. Kërkimet e tij kanë filluar aty rreth viteve 1968 për shkak të një kërkese që atij iu bë nga autoritetet e kohës. Në fakt, kërkimet e tij mbeten në letër.

Ato asnjëherë nuk u botuan derisa ai i rikthye atyre sërish pas rënies së Murit të Berlinit në vitin 1991. Ky fakt nuk ishte i panjohur, por hapja e arkivave e pasuroi më shumë kërkimin mbi hebrejtë në Shqipëri. Shumëllojshmëria e të dhënave të tyre ndihmoi shumë në profilizimin e studimeve rreth këtij komuniteti dhe kontributin që ai kishte dhënë në shumë procese historike të shqiptarëve.

Asgjë prej atyre që shkruhej në librat e historisë apo që thuhej publikisht gjatë viteve të komunizmit, nuk mund të krahasohej me atë që shkruhej në ato dokumente. Përpara syve tanë po shpalosej një faqe tjetër e historisë, krejtësisht e panjohur prej nesh, jo vetëm për fatin e hebrejve apo të popujve të tjerë, por dhe të vetë shqiptarëve”, - thotë Stafa.





Ekspozita “As mik, as armik” e artistit nga Kosova, Sokol Beqiri, është e para e këtij sezoni që vjen në Galerinë Kombëtare të Arteve, e cila do të qëndrojë e hapur deri në qershor. Artisti, 20 vjet pasi ka përfunduar lufta në Kosovë, e trajton këtë temë nëpërmjet fotografive, videove dhe instalacioneve, për të mos harruar të shkuarën

# SOKOL BEQIRI

## ART PËR TË MOS HARRUAR TMERRET E LUFTËS

Nga Suadela Balliu

Të shkruash poezi pas Auschwitz-it është barbare, thoshte filozofi gjerman Theodor Adorno. Por nëse arti është i pafuqishëm të shërojë katastrofa kaq të mëdha që njeriu i ka shkaktuar njerëzimit, ai mundet të raportojë. Këtë ka zgjedhur artisti nga Kosova, Sokol Beqiri, në rrugëtimin e tij artistik: rolin e dëshmitarit, i cili i vihet shoqërisë përballë për të na kujtuar tmerret të cilat nuk mundemi dhe nuk duhet t'i harrojmë. “As mik, as armik” e sjell artistin e njohur për herë të parë në Tiranë me një ekspozitë vetjake, ndërsa ky vit shënon edhe 20-vjetorin e luftës së Kosovës.

Ekspozita, e para për këtë sezon në Galerinë Kombëtare të Arteve, rrëfen një histori përmes veprave, mendon kuratorja Galit Eilat. Në hyrje të ekspozitës vizitorët i mirëpret një Pikachu, një krijesë fikzionale që luan rolin e ruajtës të pyllit që ndodhet prapa tij, ndërsa “Pylli i Shenjtë” është vepra që artisti ka krijuar enkas për këtë rast, me referencë nga elementet e mbinatyrshme në tragjedinë “Makbeth” të Shekspir.

Nën tematikën e heroit, artisti ka sjellë një sërë veprash, si “I Popullit”, seria e fotografive “Ushtarët”, “Beqiri’s Love Shop”, “Fuck You”, si dhe videon “Skënderbeu”, ndërkohë në veprat e tjera, si “Fundi i ekspresionizmit” dhe “Kur engjëjt janë vonë”, artisti përdor materiale dytësore për të treguar ngjarjet e ndodhura gjatë luftës. Tmerret e luftës na shfaqen krejt të zhveshura nëpërmjet syrit të të mbijetuarit dhe zgjedhjet estetike të artistit nuk e lejojnë shikuesin ta largojë shikimin. Është ky stil i drejtpërdrejtë dhe faktik që Sokol Beqiri ka zgjedhur pas vitit 1999. “Jemi të privuar edhe nga ndjenja e katarsisë; këto ngjarje kanë ndodhur dhe nga to nuk ka ardhur asnjë e mirë. Nuk gjejmë as shëlbim dhe shikuesi nuk fshihet dot nga mesazhi i qartë i punëve”, - shkruan Eilat në tekstin e saj kuratorial. Është kjo formë e teknikës, ky vështrim i palëkundur i artistit, që i kthen në jetë kujtimet e luftës në Kosovë.

Lufta gjithmonë ka kërkuar të jetë e përfaqësuar në art, në art të lavdit dhe të shenjtërimin. Dhuna portretizohet shpesh vetëm si dëshmi e uniformave të luftës dhe pozave të sovranit që ushtron dhunë, që supozohet të jetë legjitime dhe që duhet për rend politik, apo me fjalë të tjera, për vetë sovranitetin. Megjithatë, kur dhuna bëhet shprehje e përhershme e sovranit, kur të qenët i përjashtuar kthehet në normë, kur sovranit nuk përfaqëson më pushtetin, por është vetë pushteti i ushtruar, atëherë i shmanget përfaqësimit piktoresk, përveç në banalitetet e jetës së përditshme. Me reagimin e tij ndaj vrazhdësisë së luftës, është kujdesur të mos e përdorë si formë për të akuzuar armikun. Ai përpiket që me artin e tij të dalë përtej lokale, për të mbërritur tek universalja. “Është e vërtetë që, si shqiptarë, ne vuajmë e qajmë, por është edhe më e vërtetë që vuajmë e qajmë si njerëz”, - do të shprehej ai më herët. Beqiri është një prej 17 artistëve shqiptarë që morën pjesë në ekspozitën “Documenta 14”, organizuar në Athinë dhe Kassel të Gjermanisë dy vjet më parë.

Është etiketuar si provokativ, por Beqiri e ka në kredon e tij se arti nuk mund të përdoret si vegël kundër armikut. “...Vlera e qenësishme e punës humbet kur përvetësohet për qëllime politike, nacionaliste, religjioze apo ideologjike. E humb fuqinë e vet. Arti nuk duhet të përdoret kurrë si vegël për të bërë akuza”, - ka qenë gjithnjë i mendimit artisti. Edhe pse kanë kaluar 20 vjet nga përfundimi i luftës, me ndërhyrjen e trupave të NATO-s, Beqiri vazhdon të flasë me artin e tij. “Piedestali që mban emrin “Populli” nuk më kujtohet i kujt është, por përmes tij vjen manipulimi që bëhet në emër të popullit. Më tej malin mund të shohim si për të përshkruar ndërhyrjen e NATO-s. Jam mësuar që këta na kanë sjellë lirinë, por çfarë po ndodh më pas”, - rrëfen artisti në Tiranë, duke shtuar se ishte ky një çast që i lindnin shumë pyetje, të cilat i



ka shndërruar në art.

Ndërsa publikut i propozon një sërë punësh të grupuara në tematikën e gjerë, titulluar “Heroi”, artisti i interesuar rreth transformimit të vazhdueshëm që nuk di të ndalet, nuk e gjen veten tek tendenca e përgjithshme, për të parë një hero universal, për të gjithë. “Sot besoj dikë, nesër s’më del ashtu. Sot, personalisht, nuk shoh asnjë mik, asnjë armik”. Gjatë ditëve që ekspozita do të qëndrojë e hapur – deri më 2 qershor – Ministria e Arsimit ka mbështetur projektin e edukimit përmes kulturës, ku nxënës të shkollave të mesme do të vizitojnë ekspozitën dhe të njihen më mirë me ngjarjet e ndodhura gjatë luftës në Kosovë, të cilat do t’u rrëfohen nga një grup studentësh të degës së historisë në Universitetin e Tiranës.

Sokol Beqiri e quan artin e tij politik. “Fatkeqësisht, është politik, sepse politika është përzier në jetët tona më shumë seç duhet”, - do të thoshte ai. Në njëfarë mënyre, ky lloj arti i ka ardhur i imponuar nga rrethanat historike. - “Nuk kisha llogari të pikturoja lule e gjëra gazmore, kur njerëzit po vdisnin para syve të mi”. Duke reaguar ndaj realitetit ku jetonte, arti i tij u bë shprehje e qartë politike. “Gjithmonë jam munduar të reagoj në mënyrë sa më të drejtpërdrejtë ndaj rrethanave, fenomeneve dhe skenave rreth meje. Pasi politika dhe lufta pushtuan jetët tona, nuk kisha ku të shkoja.”

Hapësirat imagjinare të Beqirit reflektojnë përpjekjen paradoksale për t’i dhënë fund lëmshit materialist, ndërkohë që i jepet formë hapësirës si përgjigje ndaj narrativës së krizës, duke mohuar kushtet e dhunshme raciste, gjinore e heteronormative







që përcaktojnë kufijtë e saj të përditshëm. Beqiri ecën në zonë të errët të ideve dhe imazheve, që një platonist do ta quante imitimi i së keqes, shkruante rreth tij Shkëlzen Maliqi, duke u ndalur te shembujt e performancës në rrënojat e Pazarit të Madh të qytetit të tij të lindjes, Pejës, realizuar në vitin 1999, dhe instilacionin “Kur engjëjt vonohen”, dy vjet më vonë edhe videon “Milka” (2000), me subjektin e një thertoreje. Një parabolë e vrazhdë që evokon masakrën e civilëve gjatë luftës në Kosovë dhe më herët, gjatë konflikteve në ish-Jugosllavi, kjo vepër, sipas refleksioneve të Maliqit, kishte qëllim më të thellë, atë të përballjes me përjetësimin e së keqes.

Por më radikalen nga të gjitha ciklet e veprave të tij Maliqi do të cilësonte kur Beqiri merr zhanrin e dokumentarit të luftës dhe e trajton si një shtampë. Për këtë vepër Beqiri thekson lehtë tri fotografi të luftës të viktimave nga Peja: një djalë i vranë me thikë, trupi i të cilit u gjet në ujërat e trazuara të Lumbardhit, dhe dy viktimat të tjera që ishin vranë pasi ishin llyer me benzinë dhe u ishte vënë zjarri. Ka një tmerr të skajshëm të këtyre imazheve, siç e pranon edhe Beqiri, dhe duke i theksuar ato, ai tërheq vëmendjen tek efekti artistik i fotografive dokumentuese, veçanërisht të vëzhguara jashtë kontekstit.

“Në këtë rast, shprehia e fytyrës së djalit që pluskon në ujërat e kthjellëta të lumit të Pejës, rrezaton me bukurinë e një engjëlli që fle. Dy fotografite e trupave të djegur, mbështjellë me batanije, edhe ato të djegura, bëhen “kompozim artistik” abstrakt. A sugjeron Beqiri se ka një art të krimit? A është e durueshme kjo ide? A e denoncon kjo vepër krimin apo diabolizmin ontologjik të vetë artit, i cili bëhet në këtë rast një krim perfekt i imitimit dhe mashtrimit?” – do të shkruante Maliqi në tekstin prezantues të artistit nga Kosova në katalogun e ekspozitës “Documenta 14”, një nga më të mëdhatë në Europë. Por Beqiri ka marrë përsipër sfidën e hedhur nga filozofi gjerman Adorno. Nëse ai pyet se si mundet dikush të shkruajë një poezi që përmbledh barbarinë e Holokaustit, Beqiri i përgjigjet: “Duke bërë atë që artistët kanë bërë përherë, duke gjetur mjetet e duhura teknike.”



## “GËNJESHTARË TË VEGJËL” KONGOLI ME ROMANIN E RI, NË NJË AVENTURË KRYEQYTETASE



Shkrimtari Fatos Kongoli, pas një periudhe të gjatë heshtjeje, rikthehet me një roman të ri të titulluar “Gënjeshtarë të vegjël”, botimet “Toena”. Romani u prezantua për herë të parë në panairin e librit “Fieri 2019”, mbajtur 9-12 maj.

Në fakt, në intervistën e fundit për “ExLibris”, Kongoli sikur e pati lajmëruar se çfarë do të përmbante në thelb një lëndë e re letrare për të, kur e pyetëm nëse do shkruante tani, cila do të ishte historia, p.sh. çfarë do të ngacmonte, prekur aktualisht?

Kongoli na u përgjigj: “Me siguri do të ishte një aventurë. Do t’i hyja një aventure që nuk e di se ku do të më nxirrte. Po, nëse guxon ndonjëherë t’i hysh një aventure, qoftë edhe në moshën time, nuk është ndonjë mëkat...” Dhe ja, është e vërtetë, tregimi më i ri i Kongolit është një aventurë kryeqytetase e protagonistit të librit, Alpinin ose Alpit, siç e thërrasin, një i ri me origjinë nga fshati. Aventurë që zgjat plot dymbëdhjetë vjet, në kërkim të një ekzistence të re, në fillim si student, më pas i punësuar në një nga ndërmarrjet e mëdha të kryeqytetit. Në kërkim gjithashtu të qenies ideale të ëndrrave të tij, një vajze që nuk e njeh, nuk e ka takuar kurrë, por që e përfytyron si një qenie me “bonsens”. Në këtë rrugëtim atij i shfaqen njëra pas tjetrës Viola, më tej Rovenë, në fund Ema. Dashuritë e zhdukura nëpër botë pa lënë gjurmë të protagonistit. “Edhe në këtë roman të ri, përmes një proze që të mbërthen nga fillimi në fund, Kongoli shpalos mjeshtërisht një tablo të realitetit të sotëm shqiptar. Një realitet i egër, me problemet e shumta dhe kontrastet e thella. Individidi i zakonshëm është tepër i dobët, pothuaj i pambrojtur në këtë realitet, në mëshirë të më të fuqishmëve. Po kush janë gënjeshtarët e vegjël?” – thotë për “ExLibris” botuesja Irena Toçi. Ja një fragment nga romani:

“Ajo e mori në telefon në mes të natës. Prej gjashtë muajsh shiheshin vetëm kalimthi, me raste, nuk komunikonin dhe emri i saj ishte i fundit që priste t’i shfaqej në ekranin e celularit. Ai mbeti në mëdyshje, t’i përgjigjej apo jo; kapitullin me Emën e quante të mbyllur. Kapitulli me Emën ishte mbyllur dhe rihapur më se një herë, por gjashtë muaj të shkuar ai qe bindur përfundimisht: midis tyre nuk funksiononte. Ajo ishte e bukur, e lirshme, ndërsa ai xheloz. Kështu e akuzonte vajza. Dhe grindeshin. Pasi grindeshin, atij i ndodhte të vuante deri në atë masë sa, për të shpëtuar, ishte gati t’ia këpuste vetes. Ose të vriste Emën. Doemos, nuk bënte as njërën, as tjetrën. Përkundrazi, ajo zotëronte një aftësi të rrallë për të vendosur paqe midis tyre, kështu ai çlirohej nga idetë ogurzeza dhe gjithçka rifillonte si të mos kishte ndodhur asgjë. Këtë mendoi edhe atë mesnatë gushti, kur në ekranin e celularit iu shfaq emri i saj; po t’i përgjigjej, rrezik të binte pre e dobësisë së tij. Kjo do të thoshte të riniste historia e vjetër. Ai s’kishte kurrfarë dëshire për të rinisur historinë e vjetër. Gjashtë muaj të shkuar, pas përplasjes me Emën – thjesht një pretekst ky – kishte vendosur të ndërmernte disa veprime që i bluanë prej kohësh e që do të mund të quheshin radikale. Mbi të gjitha, të shkëpuste, më në fund, çdo marrëdhënie me kompaninë “Luga”, ku ishte i punësuar në zyrën e financave plot pesë vjet të shkuar. Mirëpo, tashmë i kishte ardhur në majë të hundës, nuk duronte dot më. Disa fytyra, duke nisur nga ajo e bosit, ia shpifnin. Kështu, i ngarkuar për gjashtë muaj radhazi me idenë e vjetër të një rebelimi, në kushtet e përballjes së përditshme me poshtërimin e vetes, ai mundi të hiqte dorë vetëm nga Ema, asgjë më shumë. ‘Çfarë drejtin kërkon ajo prej meje tani, - mendoi, - ç’hall mund të ketë që më telefonon në mes të natës?’”





# "A MURGESHË, A LAVIRE"

## Aktakuza publike e Andrej Zhdanovit për Anna Ahmatovën

Përkthyer dhe përgatitur nga Aurel Plasar

<sup>1</sup>PO KALOJ TE ÇËSHTJA E "KRIJIMTARISË" letrare të Anna Ahmatovës. Veprat e saj, kohëve të fundit, shfaqen në revistat leningradase në trajtë "ripunimesh të zgjeruara". Kjo është kaq e çuditshme dhe e panatyrshme sikur dikush sot të vihej e të ribotonte veprat e Merezhkovskit, Vjaçesllav Ivanovit, Mihail Kusminit, Andrea Bjellit, Zinaida Hippiusit, Fjodor Sollogubit, Zinovjeva-Anibalit etj., domethënë të të gjithë atyre që letërsia jonë dhe opinion ynë publik përparimtar i kanë mbajtur gjithnjë për përfaqësues të obskurantizmit reaksionar dhe të tradhtisë në politikë e në art.

Gorki, në kohën e tij, ka thënë që dhjetëvjetëshi mes 1907-s dhe 1917-s meriton të quhet si më i turpshmi e më mediokri në historinë e inteligjencies ruse, kur mbas revolucionit të vitit 1905 një pjesë e përfillshme e inteligjencies i ktheu shpinën revolucionit, rrëshqiti në batakun e mistikës reaksionare e të pornografisë, shpalli si flamur të vetin paideshmërinë, duke e maskuar tradhtinë e vet me fjalinë "e bukur": "dogja gjithë sa adhuroja, adhurova gjithë sa dogja".

Pikërisht në atë dhjetëvjetësh u shfaqën vepra të tilla renegate, si *Kali i zbehtë* i Ropshinit, veprat e Viniçenkos dhe dezertorëve të tjerë nga kampi i revolucionit në kampin e reaksionit, që nxituan t'i diskreditonin ideat e larta për të cilat luftonte pjesa më e mirë, ajo përparimtare, e shoqërisë ruse.

Dolën në dritë simbolistët, imazhinistët, dekadentët e të gjitha ngjyrave, që mohonin popullin dhe shpallnin tezën e "artit për art", që lavdëronin paideshmërinë në letërsi duke e maskuar zvetënimin e vet ideologjik dhe moral me kërkimin e formës së bukur pa përmbajtje. I bashkonte të gjithë tmerri i egër nga revolucioni proletar që po vinte. Mjafton të kujtosh që njëri prej "ideologëve" madhorë të këtyre rrymave ishte Merezhkovski, i cili e përcaktoi revolucionin proletar që po vinte si "ardhja e Kamit"<sup>2</sup> dhe i cili e priti Revolucionin e Tetorit me një mllef shtazarak.

Anna Ahmatova është njëra nga përfaqësueset e këtij batakut letrar, reaksionar dhe të paide. Ajo i përket të ashtuquajturit grup letrar të akmeistëve<sup>3</sup>, që dolën në kohën e tyre nga radhët e simbolistëve, dhe është njëra ndër flamurtaret e poezisë aristokratike të salloni, një poezie të zbrazët, të paide, kryekëput të huaj për letërsinë sovjetike. Akmeistët përfaqësonin në vetvete prirjen më individualiste të artit. Ata predikonin teorinë e "artit për art", të "së bukurës për të bukurën", dhe as donin t'ia dinin për popullin, për nevojat dhe interesat e tij, për jetën shoqërore.

Për nga origjina sociale kjo ishte një rrymë aristokratiko-borgjeze në letërsi, kur aristokracia dhe borgjezia i kishin ditët të numëruara dhe kur poetët dhe ideologët e klasave sunduese rrekeshin t'i iknin realitetit të papëlqyeshëm për t'u ngjitur në lartësitë transcendentale dhe në mjegullat e mistikës fetare, në përjetimet vetjake mjerane dhe në rrëhimin e shpirtit të tyre të vegjël e meskinë. Akmeistët, si dhe simbolistët, dekadentët dhe përfaqësuesit e tjerë të ideologjisë aristokratiko-borgjeze në dekompozim e sipër, qenë predikues të dekadentizmit, të pesimizmit, të besimit në një botë të përtejme.

Tematika e Ahmatovës është fund e krye individualiste. Deri në mjerim i kufizuar, diapazoni i poezisë saj është ai i poezisë së një zonjëze të mllefosur që vetevjen mes buduarit<sup>4</sup> dhe dhomës së lutjes. Thelbi i poezisë sa saj janë motivet erotik-dashurore, të

pleksura me motive trishtimi, brengje, vdekjeje, mistike, fataliteti. Ndjenja e fatalitetit, - ndjenjë e kuptueshme për ndërgjegjen shoqërore të një grupi në hjekë e sipër, - tonet e errëta të dëshpërimit në prag vdekjeje, përjetimet gjysmë mistike e gjysmë erotike, kjo është bota shpirtërore e Ahmatovës, një nga partallet e botës së kulturës së vjetër artistokratike të kredhur pakthyeshmërisht në amshim, botë e "të mirit mot të shkuar të Katerinës". A murgeshë, a lavire, por më shumë murgeshë e lavire bashkë, tek e cila lavirllëku është i shkaktur me lutjen fetare.

*Të bëj be për kopshtet engjëlllore,  
Për ikonën e mrekullisë të bëj be,  
Për dehjen e netëve tona të flakërore...*  
(Ahmatova, *Anno Domini*)

E tillë është Ahmatova me jetën e saj vetjake të vogël, meskinë, me përjetimet e saj pa pikë vlere dhe me erotikën e saj mistiko-fetare.

Poezia ahmatoviane është krejtësisht larg popullit. Është poezia e dhjetëmijë zotërinjve të mëdhenj të Rusisë së vjetër aristokratike, që kanë marrë fund, të cilëve nuk u ka mbetur veçse të psherëtimë për "të mirin mot të shkuar". Pallatet e çifligarëve të kohëve të Katerinës me rrugina shekullore gjithë blirë, me shatërvanë, me shtatore dhe harqe të gurta, me oranzheri, me kioska dashurikash dhe me stema të rrëguara ndër portat e mëdha. Pjetërburgu artistokratik; *Carskoje Sjello*<sup>5</sup>; stacioni i Pavlovskut e të tjera relikte të kulturës aristokratike: e gjitha kjo ka perënduar në një të shkuar pa kthim! Partallet e kësaj kulture tanimë të

largët, të huaj për popullin, që për kushedi ç'mrekulli qenkëshin ruajtur deri në kohët tona, nuk kanë ç'bëjnë më veçse të mbyllen në vetvete e të jetojnë me kimera. "Gjithçka e plaçkitur, e tradhtuar, e shitur": kështu shkruan Ahmatova.

Njëri nga përfaqësuesit më të spikatur të këtij grupi, Osip Mandelshtami, pak para revolucionit shkruante për ideat politiko-shoqërore dhe letrare të akmeistëve: "Akmeistët bashkojnë dashurinë për organizmin dhe organizimin me një mesjetarizëm fiziologjik...". "Duke e përcaktuar mbas mënyrës së saj peshën specifike të personit, Mesjeta e ndjeu dhe e njohu atë të çdokush, krejtësisht në mënyrë të pavarur prej meritave të tij...". "Po, Europa ka kaluar nëpër labirintin e një kulture të rafinuar e nazike, kur qenia abstrakte, ekzistimi aspak i zbukuruar individual çmohej si arritje e madhe. Këtu e ka burimin intimiteti aristokratik që i lidh të gjithë njerëzit dhe që është aq i huaj për nga fryma ndaj "barazisë dhe vëllazërisë" së revolucionit të madh...". "Na është e dashur Mesjeta sepse ajo zotëronte në shkallë të lartë sensin e masës dhe të caqeve...". "Një përzierje fisnike racionaliteti dhe mistike, si dhe të ndërjet e botës si një ekuilibër i gjallë na qas tek ajo epokë dhe na nxit të marrim fuqi nga veprat e letërsive që lulëzuan në truall roman gjatë shekullit XIII". Në këto deklarime të Mandelshtamit janë shpalosur aspiratat dhe ideat e akmeistëve. "Mbrapa drejt Mesjetës": ky është ideali social i këtij grupi aristokratik salloni. Mbrapa drejt majmunit: ia mban ison Zoshçenkoja. Duhet thënë që si akmeistët, edhe *Vëllezërit Serapionë* e zënë fillin e tyre të stërgjyshër të përbashkët. I par i fisit, si për akmeistët, edhe për *Vëllezërit Serapionë*, ka qenë Hoffmanni, njëri prej themeluesve të dekadentizmit e të misticizmit aristokratik të salloni.

Përse qe e nevojshme krejt papandehur të popullarizohej poezia e Ahmatovës? Ç'lidhje ka ajo me ne, me njerëzit sovjetikë? Përse u duhej vënë një tribunë letrare në dispozicion gjithë këtyre rrymave letrare dekadente dhe thellësisht të huaja për ne?

Nga historia e letërsisë ruse dimë që jo një herë a dy rrymat letrare reaksionare, të cilave u përkisnin edhe simbolistët dhe akmeistët, janë orvatur t'u kundërvihen traditave të mëdha revolucionare demokratike të letërsisë ruse, eksponentëve të saj përparimtarë; janë orvatur t'ia heqin letërsisë domethënënie e saj të lartë ideore e sociale për ta tërhequr në moçalin e paideshmërisë e të vulgaritetit. Të gjitha këto rryma





“në modë” janë kredhur tanimë në harresë e janë flakur në të shkuarën tok me klasat ideologjinë e të cilave shprehnin. Nga tërë këta simbolistë, këta akmeistë, këta *jelekverdhë*, këta *fantër karo*, këta *biçër*, çfarë ka mbetur në letërsinë tonë ruse, sovjetike? Asgjë prej gjëje, ndonëse fushatat e tyre kundër përfaqësuesve të mëdhenj të letërsisë demokratike-revolucionare ruse – Bjelinski, Dobroljubovit, Çernishevskit, Hercenit, Salltikov-Shçedrinit – qenë përgatitur gjithë zhurmë e bujë. Mirëpo me të njëjtin efekt edhe dështuan.

Akmeistët shpallnin: “Mos i bëni asnjë modifikim qenies dhe mos u merrni me kritikën e saj”. Përse ishin kundër çfarëdolloj modifikimi të qenies? Sepse atyre u pëlqente mënyra e vjetër aristokratike, borgjeze e të qenit, ndërsa populli i qe vënë shkatërrimit të asaj mënyre të qeni të tyre. Në tetorin e 1917-s u flakën në koshin e plehrave të historisë si klasat sunduese, edhe ideologët dhe këngëtarët e tyre.

Mirëpo ja ku papritur, në 29-vjetorin e revolucionit socialist, shfaqen përsëri në skenë do rrallësi muzeale nga një botë hijesh dhe fillojnë t’i mësojnë rinisë sonë se si u dashka jetuar. Para Ahmatovës çelen më kanat portat e një reviste të Leningradit dhe ajo lihet e lirë të helmojë ndërgjegjen e rinisë me frymën e qelbur të poezisë së saj.

Në revistën *Leningrad*, në njërin nga numrat, është botuar diçka si njëfarë përmbledhjeje e veprave të Ahmatovës, të shkruara në periudhën nga 1909 më 1944. Aty, tok me të tjera rraqe, është një poezi e shkruar në evakuim, në kohën e Luftës së Madhe Patriotike. Në atë poezi ajo shkruan për vetminë e saj, të cilën i duhet ta ndajë me një maçok të zi. Maçoku i zi e vështron si syri i shekullit. Tema nuk është e re. Për një maçok të zi Ahmatova shkroi edhe më 1909. Gjendjet e vetmisë dhe të parrugëdaljes, të huaja për letërsinë sovjetike, karakterizojnë gjithë rrugën historike të “krijimtarisë” së Ahmatovës.

Çfarë ka të përbashkët mes kësaj poezie dhe interesave të popullit tonë dhe të shtetit tonë? Asgjë prej gjëje. Vepra e Ahmatovës është çështje e një të kaluarë të largët; ajo është e huaj për realitetin sovjetik bashkëkohor dhe nuk mund të tolerohet në faqet e revistave tona. Letërsia jonë nuk është sipërmarrje private për të kënaqur shijet e ndryshme të tregut letrar. Nuk jemi aspak të detyruar t’u japim vend në letërsinë tonë shijeve dhe zakoneve që nuk kanë asgjë të përbashkët me moralin dhe cilësitë e njerëzve sovjetikë. Çfarë mësimi mund t’i japin rinisë sonë veprat e Ahmatovës? Asnjë, përpos dëmit. Këto vepra mund vetëm të mbjellin shkurajimin, demoralizimin, pesimizmin, dëshirën për t’u ikur problemeve të qenësishme të jetës shoqërore, për të braktisur rrugën e gjerë të jetës e të veprimtarisë shoqërore për hir botëzës së ngushtë të përjetimeve individuale. Si mund të lihet në duart e saj edukimi i rinisë sonë?! E megjithëkëtë Ahmatovës i është botuar me gatishmëri të madhe, si në revistën *Zvezda*, edhe në revistën *Leningrad*, madje edhe në vëllim. Ky është gabim i rëndë politik.

Nuk është e rastit, duke marrë parasysh gjithë këtë, që në revistat leningradase zunë të shfaqen vepra shkrimtarësh të tjerë, të cilët filluan të rrëshqasin në pozitë e paideshmërisë dhe dekadencës. Kam parasysh vepra të tilla si ato të Sadojfevit dhe të Komisarovës. Në disa poezi të tyre Sadojfevi dhe Komisarova nisën t’i mbajnë ison Ahmatovës, nisën të kultivojnë ndjenjat e dëshpërimit, të brengës, e të vetmisë.

Vetëkuptohet që gjendje të tilla ose predikimi i gjendjeve të tilla mund të ushtrojë vetëm ndikim negativ në rininë tonë, mund t’ia helmojnë asaj ndërgjegjen me frymën e prishur të paideshmërisë, të apolitizmit, të dëshpërimit.

Por ç’do të kishte ndodhur nëse ne do ta kishim edukuar rininë me frymën e dëshpërimit dhe të mosbesimit në kauzën tonë? Do të kishte ndodhur që të mos e kishim fituar Luftën e Madhe Patriotike. Pikërisht sepse shteti sovjetik dhe partia jonë, me ndihmën e letërsisë sovjetike, e edukuan rininë tonë me frymën e guximit, të besimit në forcat e veta, pikërisht prandaj i kapërcyem vështirësitë tejmase të mëdha në ndërtimin e socializmit dhe arritëm fitoren mbi gjermanët dhe japonezët.

<sup>1</sup> Nga Raporti i Andrej Zhdanovit për revistat “Zvezda” (“Ylli”) dhe “Leningrad” në mbledhjen e Arkivit të Partisë dhe në mbledhjen e Shkrimtarëve të Leningradit. Fjala e marrë me stenogram u botua në gazetën “Pravda”, nr. 225 (10307) të datës 21 shtator 1946. Në atë kohë Andrej Zhdanovi (1896–1948) kryente funksionin e kryetarit të Presidiumit të Sovjetëve të Bashkimit Sovjetik. Nikita Hrushçovi ka treguar në Kujtimet e veta që Stalini e kishte llogaritur Zhdanovin si mbasardhësin e vet. Raporti i tij paraprihej nga një Vendim i Byrosë Politike të KQ të Partisë Komuniste (Bolsheviqe) të BRSS i datës 14 gusht 1946. Përpos masave ndaj revistat në fjalë, Vendimi njoftonte përjashtimin e shkrimtares Anna Ahmatova dhe të shkrimtarit Mihail Zoshçenko nga Bashkimi i Shkrimtarëve të Bashkimit Sovjetik. Me këtë Vendim dhe me këtë Raport filloi në BS ndaj autorëve që nuk i konformoheshin “realizmit socialist” reprezalja e njohur si “vitet e zhdanovshçinës”. Veçan mbi poeten binte prej atij viti censura e egër, duke pasur parasysh edhe faktet që të shoqin, poetin gjithashtu akmeist Nikollaj Gumiljov, ia kishin pushkatuar qysh më 1921 me akuzën e “veprimtarisë kundërrevolucionare”, ndërsa të birin, shkencëtarin Lev Gumiljov, ia kishin arrestuar dhe burgosur. Dokumentet në fjalë u botuan edhe në Shqipëri dhe patën ndikimin e tyre filli në farkëtimin e kritikës dogmatike të modelit zhdanovist ndaj shkrimtarëve dhe artistëve në vend. Prej vitit 1947 *zhdanovshçina* u propagandua në mjediset e shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë nga funksionarë partiakë, si Nexhmije Hoxha, Liri Belishova etj. Më 1988 në Bashkimin Sovjetik Vendimi i përmendur i 14 gushtit 1946 u cilësua “i gabuar” dhe i anuluar (shën. i përkth. si dhe vijuesit).

<sup>2</sup> Në kuptimin e popujve orientale, që mendohej se vinin prej Kamit, njëri prej bijve të Noes.

<sup>3</sup> Akmeistët: Lëvizja letrare ruse e njohur si akmeizëm e merrte emrin nga termi akmé (ακμή), që në greqishten e vjetër kishte kuptimin e kulmit, të majës. Lindi si kundërvënje ndaj simbolizmit, duke i vënë theksat e krijimtarisë poetike te një stil i ri shprehës, më i qartë e më konkret, si dhe te vlerat formale të vargut. Kreu i saj mbahet poeti Nikollaj Gumiljov, bashkëshorti i pushkatuar më 1921 i Anna Ahmatovës, e cila qe gjithashtu përfaqësuese e spikatur e lëvizjes akmeiste, tok me të tjerë emra të shquar, si Osip Mandelshtam, Mihail Kuzmin etj. E lindur më 1909 ose 1910, pavarësisht peripecive për shkak të dhunës dogmatike të kritikës zyrtare sovjetike, në Rusinë sovjetike lëvizja ia doli të mbijetonte deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore.

<sup>4</sup> Fr. boudoir: salloni i vogël intim zonjash.

<sup>5</sup> Rus. “Fshat i carit”: quhej kështu rezidenca verore, në trajtë kompleksi pallatesh, e carëve në afërsi të Pjetërburgut.



# FJALË PËR PUSHKININ

## Nga Anna Ahmatova

*Përkthyer nga Aurel Plasari*

Paraardhësi im P. E. Shçjogoljev e përfundon punimin e tij për duelin dhe vdekjen e Pushkinit me një varg vrojtimesh se përse shoqëria e lartë, përfaqësuesit e saj, e urryen poetin dhe e refuzuan atë si trup të huaj nga mjedisi i tyre. Sot ka ardhur koha për ta përmbysur problemin dhe për të thënë me zë të lartë jo çfarë i bënë *ata* atij, por çfarë u bëri *ai* atyre.

Mbas atij oqeani balte, tradhtie, gënjeshttrash, moskokëçarjeje të miqve dhe budallallëku të pastër nga ana e Poljetikave dhe jo-Poljetikave, e kushërinjve Stroganov, e gardistëve idiotë të kalorësive që e bënë historinë e D’Anthèsit *une affaire de régiment*, e salloneve hipokrite të zonjës Neselrod etj., e oborrit suprem që përgjonte nëpër gjithë vrimat e çelësit, e të madhërishtëve këshilltarë sekretë, – anëtarë të Këshillit të Shtetit që nuk patën turp ta vinin poetin gjenial nën mbikëqyrjen e policisë, – mbas gjithë kësaj: se ç’mrekullim e ngadhënjim ta shohësh atë Pjetërburg të rremë e të pashpirt (“derrëror” e quajti poeti), madje edhe injorant, tek shtrëngohej të vështronte mijëra e mijëra njerëz që, me të marrë vesh lajmin e kobshëm, u dyndën në shtëpinë e tij dhe së toku me gjithë Rusinë mbetën aty.

“*Il faut que j’arrange ma maison*”, – tha Pushkini ndërsa vdiste. Dy ditë më vonë shtëpia e tij u bë vend i shenjtë për atdheun e tij dhe fitore më të plotë e më të shkëlqyer bota nuk pa.

E gjithë epoka, vetëkuptohet jo pa kërcitje, pak nga pak filloi të quhej “epokë pushkiniane”. Të gjitha bukuroshet, zonjat e nderit, padronet e salloneve, damat kalorësiake, anëtarët e oborrit perandorak, ministrat, komandantët dhe jokomandantët, filluan ca nga ca të quheshin “bashkëkohës të Pushkinit”, ndërsa mandej thjesht u dergjën kartotekave dhe treguesve të botimeve të Pushkinit me datat e lindjes e të vdekjes të shtrembëruara.

Ai ngadhënjëu edhe kohën, edhe hapësirën.

Thonë: epoka e Pushkinit, Pjetërburgu i Pushkinit. Dhe kjo nuk ka të bëjë me drejtpërsëdrejti me letërsinë, kjo është diçka tjetër. Në sallat e pallateve, ku vallëzonin dhe përhapnin thashetheme për poetin, janë varur portretet e tij dhe ruhen librat e tij, ndërsa hijet e tyre mjerane janë dëbuar së andejmi përgjithnjë. Për pallatet dhe vilat e tyre madhështore thonë: këtu ka qenë Pushkini, këtu nuk ka qenë Pushkini. Gjithçka tjetër nuk i intereson askujt. Zotëria e tij perandori Nikollaj Pavloviç, në geta të bardha, shpalos hiret e veta në murin e muzeut të Pushkinit. Dorëshkrime, ditarë, letra zënë e vlerësohen nëse shfaqet aty fjala magjike “Pushkin” dhe, ç’është më e tmerrshmja për ta, mund të dëgjonin prej poetit:

*Për mua s’do të jepni llogaritë,  
Fuqia paska qenë e drejta juaj.  
Flini të qetë, vetëm se një ditë  
Do ju mallkojnë për mua bijtë tuaj.*

Dhe më kot pandehin njerëzit se dhjetëra monumente të bëra me dorë do të mund të konkurronin atë monument të pabërë me dorë, *aere perennius*: më jetëgjatë se bronzi.

*Komarovo, 26 maj 1961*



Monika Stafa

# HEBRENJTË NË SHQIPËRI

*Me parathënie nga  
Ismail KADARE*

Onufri

